



**RIINVEST**  
INSTITUTI PËR HULLIMTË ZHVILLIMORE  
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT RESEARCH

FORUMI EKONOMIK VJETOR

# NJË MODEL I RI PËR RRITJEN E QENDRUESHME EKONOMIKE

dinamika e tregut të punës: sfidat  
aktuale dhe të ardhshme



NËNTOR, 2023



# NJË MODEL I RI PËR RRITJEN E QENDRUESHME EKONOMIKE

dinamika e tregut të punës:  
sfidat aktuale dhe të ardhshme

#### **PËRGATITUR NGA:**

Alban Hashani – udhëheqës i projektit  
Muhamet Mustafa – koordinator i projektit  
Alma Bajramaj  
Benet Maloku  
Berat Havolli  
Gent Beqiri  
Halim Mahmuti  
Liridon Kryeziu  
Luan Shllaku  
Petrit Gashi  
Pëllumb Çollaku  
Tringë Shkodra  
Valentin Toçi  
Visar Vokrrri

#### **MBËSHTETUR NGA:**



**EYE** Enhancing Youth  
Employment

#### **BOTUAR NGA:**

INSTITUTI RIINVEST  
Lidhja e Prizrenit nr. 56 Prishtinë 10000,  
Republika e Kosovës  
Tel: + 381 (0)38 244320;  
[www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)

Këndvështrimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve. Instituti Riinvest merr përsipër përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e këtij raporti.

E drejta autoriale © 2023 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem reproduktimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa e cituar burimin.

# Përmbajtja

<b>SHKURTESAT .....</b>	<b>6</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>7</b>
<b>HYRJE.....</b>	<b>10</b>
<b>PJESA I .....</b>	<b>11</b>
<b>RRITJA EKONOMIKE DHE KONFIGURACIONI MAKROEKONOMIK .....</b>	<b>11</b>
1.1. Konteksti Global .....	12
1.2. Trendi i rritje ekonomike dhe nevoja për modelin e ri të rritjes ekonomike.....	13
1.2.1. Modeli ekzistues i politikave ekonomike dhe nevoja për modifikim.....	14
1.2.2. Sektori i jashtëm.....	15
1.2.3. Sektori Financiar.....	20
1.2.4. Shpenzimet qeveritare – Buxheti .....	21
1.2.4.1. Struktura e Shpenzimeve Buxhetore.....	24
1.2.4.2. Analiza e Borxhit Shtetëror .....	27
<b>PJESA II .....</b>	<b>29</b>
<b>MJEDISI BIZNESOR.....</b>	<b>29</b>
2.1 Barrierat në mjedisin biznesor ndër vite.....	30
2.2 Rregullativa ligjore dhe fiskale .....	32
2.3 Investimet dhe barrierat financiare .....	32
2.4 Ekonomia informale dhe korrupsioni.....	32
2.5 Tregu i punës dhe barrierat e ndërlidhura me ndërmarrësinë .....	34
2.6 Barrierat administrative dhe infrastruktura .....	34
<b>PJESA III .....</b>	<b>37</b>
<b>TREGU I PUNËS.....</b>	<b>37</b>
3.1 Hyrje .....	38
3.2 Vështrim i përgjithshëm i tregut të punës në Kosovë .....	38
3.3 Kërkesa për fuqi punëtore dhe vështirësi në plotësimin e pozicioneve .....	39
3.4 Vështirësi në mbajtjen e punonjësve.....	45
3.5 Procesi i rekrutimit dhe praktikat e Burimeve Njerëzore .....	49
3.6 Kushtet e punës.....	51
<b>Referencat.....</b>	<b>52</b>
<b>Anex 1.....</b>	<b>56</b>

# Shkurtesat

<b>ASK</b>	Agjencisë së Statistikave të Kosovës
<b>BB/ WB</b>	Banka Botërore
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BP6</b>	Vendet e Ballkanit Perëndimor
<b>BQK</b>	Banka Qendrore e Kosovës
<b>BNJ</b>	Burime Njerëzore
<b>CEFTA</b>	Marrëveshja për tregtinë e lirë të Evropës Qendrore
<b>EBRD</b>	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>FMN/ IFM</b>	Fondi Monetar Ndërkombëtar
<b>KFOS</b>	Fondacionit Kosovar për Shoqërinë e Hapur
<b>Trusti</b>	Fondi i Kursimeve Pensionale
<b>ICT</b>	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimeve
<b>IJD/FDI</b>	Investimet e jashtme direkte
<b>KASH</b>	Kornizën e Shpenzimeve Afatmesme
<b>MFPT</b>	Ministria e Financave , Punës dhe Transfereve
<b>NVM</b>	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
<b>OECD</b>	Organisation for Economic Co-operation and Development
<b>OSHP</b>	Organit Shqyrtues të Prokurimit
<b>PIP</b>	Programi i Investimeve Publike
<b>PVB</b>	Produkti Vendor Bruto
<b>R&amp;I</b>	Kërkime dhe zhvillim
<b>ROA</b>	Kthimi nga asetet
<b>ROE</b>	Kthimi nga ekuiteti
<b>S3</b>	Strategjia e Specializimit të mençur
<b>TVSH</b>	Tatimi i Vlerë së Shtuar
<b>VET</b>	Vocational Education and Training
<b>wiiw</b>	Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME

Pas daljes nga faza e incidencës së lartë të COVID-19, dhe rritjes ekonomike prej 10.7 përqind në vitin 2021, në vitet vijuese ekonomia e Kosovës kthehet afërsisht tek një rritje karakteristike në dekadën e fundit 3-4 përqind, përkatësisht 3.5 përqind në vitin 2022. Një tendencë ngadalësimi përshkon vitin 2023 në tremujorin e parë (2.9%) dhe në tremujorin e dytë (2.06%) e shoqëruar kjo edhe me përkeqësimet në rritjen e eksportit dhe në bilancin tregtar. Sipas të gjitha gjasave, gjykuar edhe sipas parashikimeve edhe për rrjedhat ekonomike në Bashkimin Evropian (BE), dhe në planin global kjo do të mbetet një karakteristike e ecurive edhe për vitin 2024. Ky nivel i rritjes është nën pritjet dhe përcaktimet e Qeverisë së Kosovës në Programin Qeveritar dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) e cila kishte parashikuar një rritje mbi 5 përqind për të tri vitet, brenda periudhës 2022-2024. Në dokumentet që shoqërojnë projekt-Buxhetin e vitit 2024, parashikohet një rritje prej 4.6 përqind.

Kosova është e mbërthyer brenda një kornize politikash e faktorësh që, siç provojnë statistikat për më shumë se një dekadë e gjysmë, mbajnë të pandryshueshme strukturën e Produktit Vendor Bruto (PVB). Sektorët prodhues dhe industria përpunuese nuk kanë arritur ndonjë përmirësim. Si pasojë, modeli ekzistues i rritjes ekonomike, i bazuar në faktorët të jashtëm, pothuajse ka harxhuar fuqinë e tij për rritje ekonomike transformuese. Atij po i mungojnë shtytësit zhvillimor dhe më tepër po konservon një gjendje që në teorinë dhe praktikën e zhvillimit njihet si kurthi zhvillimor i vendeve me të ardhura mesatare.

Tejkalimi i këtij problemi, edhe në rastin e Kosovës, duhet të bëhet me **promovimin e Modelit të ri të rritjes ekonomike të bazuar në politikat e rritjes së ofertës konkurruese** të produkteve dhe shërbimeve për tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Kjo nënkupton edhe një përdorim më efektiv të fondeve publike sidomos në dobi të një investimi më frut-

dhënës në arsim, shëndetësi dhe kërkime e inovacion. Me këtë krijohen kushtet afatgjata për të ngritur potencialin për rritje ekonomike të qëndrueshme, sidomos duke u ndërlidhur me angazhimet e tanishme, shumë të rëndësishme, lidhur me hartimin dhe aprovimin e Strategjisë së Specializimit të Mençur (S3), Strategjisë për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030, zbatimin Agjendës së Gjelbër dhe Digjitalizimit. Në kudër të kësaj duhet rritur ndjeshëm investimet publike dhe private në kërkime dhe inovacion (K&I) dhe së paku këto investimi të arrijnë mesataren rajonale (prej rreth 0.5% të PVB) për një periudhë 2-3 vjeçare. Pjesë përbërëse e këtij sistemi të integruar politikash konsistente është edhe mbështetja aktive e sektorëve me performancë eksportuese, përmirësimi i qasjes dhe pozitës së këtyre sektorëve në financa e kreditim afatgjatë, avancimi i politikave fiskale e buxhetore e para së gjithash tejkalimi i dobësive dhe ineficiencës së theksuar në realizmin e Programit të Investimeve Publike (PIP).

Pavarësisht sfidave të shumta me të cilat sistematikisht është përballur sektori privat në Kosovë përgjatë dy dekadave të fundit, nuk kanë munguar përpjekjet institucionale në funksion të përmirësimit të ambientit biznesor në vend, dhe gjykuar sipas raporteve nga shumë burime, ka pasur një trend përmirësimi. Andaj, përmirësimi i klimës biznesore – përfshirë aspektet ligjore, financiare, rregullatore dhe institucionale – përmes fuqizimit të sundimit të ligjit dhe politikave të favorshme për sektorin privat, është hap tejet i rëndësishëm drejt rritjes së qëndrueshme ekonomike. Megjithatë perceptimet e bizneseve për këtë evoluim nuk janë të kënaqshme. Sa i përket intensitetit të barrierave, sivjet prin dukshëm migrimi i fuqisë punëtore me 75 pikë nga 100 maksimale. Kjo pastaj shoqërohet me një varg barrierash me intensitet mbi mesatar (ndërmjet 57-66 pikë), si madhësia e tregut, normat tatimore, ngarkesat dhe pengesat administrative, kosto e financimit, informaliteti dhe evazioni fiskal si burime të konkurrencës së pandershme,

korupsioni dhe kriminaliteti, ndërveprimi me administratën tatimore dhe doganat, furnizimi me energji elektrike, inkasimi i borxheve dhe siguria politike.

Vlen të theksohet që vitin e kaluar Qeveria e Kosovës ka miratuar Programin për Parandalimin e Barrës Administrative (2020-2027), – një iniciativë ndërinstucionale e cila synon të zvogëlojë barrën administrative për qytetarët, bizneset dhe shoqërinë (ZKM, 2022). Si pjesë e këtij programi, Kosova ka lansuar një vlerësim bazë të të gjitha ngarkesave administrative për bizneset, duke identifikuar 11 ligje, 26 akte nënligjore dhe 2 vendime të ministrive që duhet të ndryshohen ose shfuqizohen për të përmirësuar mjedisin e biznesit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) (ZKM, 2022). Nevojitet intensifikim i aktiviteteve për zbatimin e këtij programi

Në anketën e zhvilluar nga Instituti Riinvest me një mijë biznese, rezulton se Kosova vijon të ballafaqohet me sfida të mëdha në tregun e punës. Përderisa shkalla e papunësisë ka shënuar rënie (në 12.6 përqind në vitin 2022), niveli i punësimit si përqindje e popullsisë mbetet i ulët (33.8 përqind). Duket se këtu ndikim ka pasur edhe rënia e shkallës së pjesëmarrjes së fuqisë punëtore nga mbi 40 përqind në 38.6 përqind e ndikuar edhe nga migrimi. Këto të dhëna janë veçanërisht shqetësuese për të rinjtë dhe gratë.

Afërsisht gjysma e bizneseve presin që të rrisin numrin e punëtorëve në tre vitet e ardhshme. Kërkesa më e madhe për punëtorë do të jetë në profesionet elementare (ISCO 9), pasuar nga punonjësit e bujqësisë (ISCO 6) dhe punonjësit e zejës dhe profesioneve të ngjashme (ISCO 7). Megjithatë, sfidat që hasin bizneset në plotësimin e kërkesës së tyre për punëtorë mbeten të mëdha. Ato veçanërisht ndërlidhen me trendet e larta të emigrimit dhe prirjes së lartë për emigrim, mungesën e punonjësve të kualifikuar dhe mospërputhjen e pritjeve për pagat dhe kushtet e punës.

Duke filluar nga viti 2016, për çdo vit, rreth 1 për qind e popullsisë së Kosovës ka emigruar drejt Gjermanisë me leje pune, apo rreth 120,000 individë në moshë pune. Në terma relativ, kjo përqindje është mesatarisht dy herë më e lartë se vendet tjera të Ballkanit Perëndimor.

Lejet e punës për kosovarë në Gjermani janë lëshuar kryesisht në sektorin e ndërtimitarisë (NACE Seksioni F), duke përfshirë më shumë se 50 për qind të lejeve të punës. Sektori i dytë më i madh që punëson punonjës kosovarë është sektori i aktiviteteve të akomodimit dhe shërbimeve të ushqimit (NACE Seksioni I), që përbën mbi 16 për qind të fuqisë punëtore. Rreth 15 për qind të punonjësve janë të punësuar në aktivitetet administrative dhe shërbimet e mbështetjes (NACE Seksioni N).

Për më tepër, bizneset raportojnë se 17.59 përqind e punonjësve të tyre veçse i kanë informuar se do të emigrojnë vitin e ardhshëm. Vlerësimet e bizneseve janë se rreth 32.72 përqind e punëtorëve do të emigrojnë gjatë vitit të ardhëm, kur pritet të liberalizohen vizat për në zonën Schengen. Për të frenuar këtë trend, vetëm gjatë vitit të fundit, 79 për qind e bizneseve kanë rritur pagat e tyre dhe rritja e pagave ishte 22.23 për qind. Mbi një e treta e bizneseve raportojnë se do të vijojnë t'i rrisin pagat, përderisa 24,5 për qind planifikojnë të përmirësojnë kushtet e punës, ndërsa 20,6 për qind planifikojnë të punësojnë gra (kryesisht në moshë të mesme), dhe 10,4 për qind planifikojnë të investojnë në teknologjitë e reja që synojnë automatizimi e proceseve të punës.

Nga ana e ofertës, evidentohet një prirje e lartë për emigrim. Pothuajse gjysma e të rinjve të anketuar kanë pohuar se ata synojnë të emigrojnë në dy vitet e ardhshme. Për më tepër, një e treta e atyre që kanë lënë punën, e ka bërë një gjë të tillë për shkak të emigrimit. Hartuesit e politikave duhet të përqendrohen në minimizimin e faktorëve shtytës në mënyrë që të ulët prirja për të emigruar. Është me rëndësi të ceket se papunësia duket se është vetëm një nga faktorët domethënës shtytës. Arsyeja kryesore për emigracionin mbetet mundësia për 'jetë më cilësore për vetën ose familjen' (27 përqind), e ndjekur nga 'gjetja e një pune ose një pune më të mirë' (26 përqind), 'ndjekja e studimeve të mëtutjeshme' (14 përqind) ose 'faktorët e kombinuar' (32 përqind). Analizimi i prirjes për të migruar dhe reagimi i vendosur në lidhje me migracionin ka implikime të rëndësishme politike dhe menaxheriale. Lidhur me këtë, janë analizuar edhe dy modele: (i) përcaktuesit që nxisin emigrimin nga Kosova, me theks të veçantë në demografinë e të rinjve, dhe (ii) karakteristikat e bizneseve që kanë humbur punëtorët për shkak të migrimit. Rezultatet e këtyre modeleve dhe ato nga analiza përshkruese ofrojnë rekomandime rëndësishme të politikeve.



## **Bazuar në gjetjet dhe konstatimet e këtij raporti rekomandojmë që:**

1. Brenda një afati racional të bëhet rishikimi i politikave ekzistuese ekonomike dhe efektivitetit të zbatimit të tyre në harmoni me nevojën për promovimin dhe zbatimin e modelit të ri të rritjes ekonomike të përqëndruar në rritjen e qëndrueshme të ofertës së produkteve shërbimeve;
2. Të dizajnohet dhe zbatohet një model politikash efektive të ngritjes së aftësisë konkurruese, sidomos duke mbështetur sektorët eksportues;
3. Në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat të lansohen programe të mbështetjes (vija kreditore) të investimeve afatgjate të sektorëve industrial dhe shërbimeve;
4. Investimet jashtme direkte sidomos ato nga diaspora të kanalizohen me stimuj të caktuar në sektorët e prodhimit dhe shërbimeve me vlerë të lartë shtuese;
5. Të rishikohen politikat buxhetore në favor të krijimit të një përpjesëtimi më të mirë struktural, para së gjithash në favor të investimeve kapitale dhe për të arritur një pozitë më të volitshme të financimit të arsimit, shëndetësisë, kërkimeve dhe inovacioneve së paku në nivel rajonal dhe përafuar me standardet evropiane;
6. Për të parandaluar nivelin e lartë të emigrimit kërkohet një strategji gjithëpërfshirëse e cila kërkon përmirësime, ndër të tjera, të sistemit të përgjithshëm arsimor, sistemit shëndetësor dhe kushteve të punës në përgjithësi si dhe në sistemin e pagave në sektorin publik dhe privat.
7. Nevojitet një aktivitet i përqëndruar dhe sistematik për evitimin e barrierave administrative dhe të zbatimit të ligjit nga të gjitha institucionet dhe agjencitë përgjegjse dhe për të zbatuar Programin e Qevrisë për Parandalimin e Barrës Administrative (2020-2027).

# HYRJE

Ky Raport është përgatitur për të mbështetur debatin në FORUMIN Ekonomik Vjetor të Institutit Riinvest (nëntor 2023). Me qëllim të ngritjes së cilësisë së debatit mbi zhvillimet ekonomike Instituti Riinvest synon organizimin e një tubimi vjetor në pjesën e parë të tremujorit të IV-të të çdo viti me pjesëmarrës të zgjedhur nga institucionet, asociacionet e biznesit dhe udhëheqës ekzekutiv të bizneseve, ekspertë nga bankat dhe qarqet kërkimore e akademike. Në përgatitje të këtij tubimi Instituti Riinvest harton një Raport lidhur me ecuritë ekonomike, problemet prezente dhe adresimin e tyre, pritjet për të ardhmen, sidomos në vitin vijues dhe politikat ekonomike që do të duhej të ishin përgjigje ndaj zhvillimeve aktuale dhe të pritshme. Synohet që raporti i prezantuar nga Instituti, pjesëmarrësit si dhe forma e punës në Forum të sigurojnë një qasje unike dhe produktive që këtë ngjarje do ta “brendonin” si debatin më serioz për ekonominë në vend. Si i tillë do të pritej me interesim për të ndriçuar çfarë ndodhi në tre tremujorët e vitit aktual dhe çfarë pritet të ndodhë në vitin vijues.

Raporti do të trajtojë:

- Gjendjen aktuale dhe zhvillimet e pritura duke pasur në konsideratë edhe kontekstin dhe zhvillimet në rrafshin rajonal, evropian e më gjerë;
- Problemet kyçe që sfidojnë dinamikën e rritjes ekonomike dhe stabilitetin makroekonomik duke vlerësuar edhe adresimin e tyre nga akterët përgjegjës;
- Zhvillimet lidhur me mjedisin biznesor;
- Një fushë të zgjedhur nga aktualiteti – sivjet adresohet tregu i punës dhe lëvizjet migruese;
- Rekomandimet dhe përgjigjet e nevojshme me politikat publike.

Ky raport është përgatitur duke analizuar studimet e Institutit Riinvest, Programin Qeveritar dhe reflektimet të tij, Raporti për Menaxhimin e Borxhit publik, Buxhetit për vitin 2023, Korniza e shpenzimeve afatmesme 2024-2026 dhe Drafti i Buxhetit të Kosovës për vitin 2024, raportet për konsumin buxhetor; kumtesat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës lidhur me ecuritë në sektor të ndryshëm gjatë vitit 2023, Raportet mujore dhe vjetore të BQK-së; raportet e fundit të FMN-së, BB-së, EBRD-së, BE-së si prognozatat e Institutit të Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiw). Veç


kësaj është zhvilluar një anketë me një mijë biznese (shtator-tetor 2023), si dhe janë zhvilluar bisedat të veçanta me udhëheqësit ekzekutivë të disa kompanive private që përfaqësojnë një ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës.

Raporti është i ndarë në tri pjesë. Pas kësaj hyrjeje, në pjesën e parë trajtohet ecuria e rritjes ekonomike përgjatë disa viteve të fundit dhe atë në kontekstin e konfigurimit makroekonomik të Kosovës të karakterizuar me shpërpjesëtime të shprehura veçanërisht me papunësinë e lartë dhe deficitin tepër të lartë tregtar të Kosovës. Në lidhje me këtë është argumentuar nevoja e modifikimit të modelit të zhvillimit ekonomik, pra nevoja për një model të ri të rritjes ekonomike për të adresuar këto shpërpjesëtime tanimë kronike. Në këtë pjesë adresohen mundësitë, që burojnë nga realiteti i brendshëm, por edhe nga konteksti rajonal dhe global që krijon disa kufizime dhe rreziqe lidhur me lëvizjet ekonomike globale, në BE dhe rajon. Ndonëse pothuajse është tejkaluar situata lidhur me COVID-19, përsëri trendet ekonomike pritet të ndikohen nga agresioni në Ukrainë, jo stabilitetin në veri të Kosovës si dhe përkeqësimi i situatës në Lindjen e Mesme.

Në pjesën e dytë adresohet mjedisi biznesor në Kosovë dhe refleksionet e tij në situatën ekonomike sivjet dhe vitin e ardhshëm. Ndërkaq në pjesën e tretë është tema qendrore e këtij Raporti, që ka të bëjë me lëvizjet më të reja në tregun e punës të ndikuara nga trendi permanent i migrimit të popullatës dhe fuqisë punëtore të punësuar kryesisht në BE, problemin e pagave në sektorin privat dhe atë publik. Kjo ka sjellë edhe ashpërsimin e problemeve strukturale të papunësisë që lidhen me mungesën e fuqisë punëtore për disa profesione e sektorë si dhe paraqitjen për herë të parë të dukurisë së importit të fuqisë punëtore në Kosovë, kryesisht nga disa vende aziatike.

Kërkimet për përgatitjen e këtij Raporti janë mbështetur nga garanti i Fondacionit Kosovar për Shoqërinë e Hapur (KFOS) dhe ndërlidhen edhe me aktivitetet e Forumit 2015. Ky studim dhe organizimi i forumit është mbështetur edhe nga projekti EYE (ang. Enhancing Youth Employment) i cili zbatohet nga Helvetas dhe MDA e financohet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SDC). Konstatimet e prezantuara përfaqësojnë pikëpamjet e ekipit kërkimor, përkatësisht të Institut Riinvest.

**RRITJA EKONOMIKE  
DHE KONFIGURACIONI  
MAKROEKONOMIK**



## 1.1 Konteksti Global

Ekonomia globale edhe përgjatë kësaj periudhe është duke u përballur me pasiguri të mëdha, të cilat janë duke u manifestuar si rezultat i akumulimit të ndikimeve nga pandemia Covid-19 si dhe nga ndikimet e agresionit rus në Ukrainë. Përveç se këto zhvillime negative kanë krijuar pasiguri për periudhën aktuale, prospektet për periudhën afat-mesme nuk duken të jenë shumë optimiste dhe vazhdojnë të jenë të varura në masë të madhe nga zhvillimet e konfliktit në Evropën lindore si dhe efekteve të shtrëngimit të politikave monetare si kundërveprim ndaj rritjes së përgjithshme të çmimeve.

Në pjesën e parë të këtij viti, ekonomia globale tregoi shenja të stabilitetit edhe pse ky ishte një stabilitet i brishtë. Në një masë të konsiderueshme, zinxhirët e furnizimit u rikuperuan dhe kostot dhe koha e transportimit të mallrave u kthye në vlera e njëjta me ato të para-pandemisë. Megjithatë, edhe pse gjatë këtij viti rritja e çmimeve të mallrave dhe energjisë u ngadalësua në raport me vitin e kaluar, niveli i përgjithshëm i inflacionit vazhdon të mbetet i lartë dhe të reduktoj ndjeshëm fuqinë blerëse të ekonomive familjare. Si rezultat bankat qendrore ndërmorën veprime duke shtrënguar politikën monetare të cilat janë duke reflektuar në vështirësimin e kredi-marrjes dhe ngritjen e normave të interesit. Ndikimet e ndryshimeve në politikën monetare janë duke u transmetuar përtej ngadalë-

simit të aktiviteteve ekonomike. Në ekonomitë e avancuara, stabiliteti financiar dhe në veçanti stabiliteti i sistemit bankar është duke u testuar seriozisht, ndërsa në vendet në zhvillim dhe në ato të varfëra, normat e larta të interesit janë duke renduar financat publike dhe nivelet e përgjithshme të borxhit publik. Si rrjedhojë, forcat që diktuan zhvillimet ekonomike globale të tri viteve të kaluara (pandemia Covid-19, lufta në Ukrainë dhe shtrëngimi i politikave monetare për të luftuar inflacionin) pritet të jenë përcaktues të rrjedhjeve ekonomike edhe përgjatë vitit 2023 dhe potencialisht edhe në vitet vijuese duke ngadalësuar rritjen ekonomike.

Si rezultat i këtyre faktorëve determinuese si dhe gjithash-tu, fragmentimeve të larta gjeopolitike me pasoja në mbar-varshmerin e tregtimit të lirë të mallrave, pritshmëritë për zhvillimet e gjithmbarshme ekonomike paraqiten të jenë modeste. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe projeksioneve të tyre të gjysmë-vitit, rritja ekonomike botërore pritet të bie nga 3.5% (2022), në rreth 3% gjatë vitit 2023 dhe 2024. Ndërsa, niveli i përgjithshëm i inflacionit pritet të bie nga 8.7% sa vlerësohet të ishte gjatë vitit 2022 në rreth 7% në vitin 2023 dhe rreth 5% gjatë vitit 2024. Ekonomia e zhvilluara pritet të kenë një rritje më të ngadalësuar dhe në mesatare rritja ekonomike pritet të jetë jo më e lartë se 1.5% gjatë vitit 2023 dhe 2024. Ndërsa ekonomitë në zhvillim pritet të kenë një rritje prej rreth 4% gjatë vitit 2023 dhe vitit 2024.

● **Tabela 1.** Projektionet për rritjen ekonomike në botë

	Sondazhi i shtatorit	
	2023	2024
Bota	2.5	2.1 ↓
Tregjet në zhvillim dhe ekonomitë në zhvillim	3.1	3.3 ↑
Kina	5.0	4.5 ↓
Ekonomitë e zhvilluara	1.4	0.9 ↓
Shtetet e Bashkuara	2.1	0.9 ↓
Eurozona	0.5	0.7 ↑
Gjermania	-0.4	0.6 ↑

Burimi: Banka Botërore: Konsensusi i ekonomiksit

## 1.2 Trendi i rritje ekonomike dhe nevoja për modelin e ri të rritjes ekonomike

Pas një rritjeje së pritshme ekonomike përtej 10% (2021), pas daljes nga faza e incidencës së lartë të COVID-19, në vitet vijuese 2022 dhe 2023 ekonomia e Kosovës kthehet afërsisht tek një rritje karakteristike në dekadën e fundit 3-4%. Megjithatë duket se ka një tendencë ngadalësimi. Kjo paralajmërohet me ecuritë në këtë vit kur kemi rënie të normës së rritjes, nga 3.5 % sa ishte në vitin 2022, në 2.9%, në tremujorin e I-rë, në 2.06 % në tremujorin e II-të. 2023. Sipas të gjitha gjasave, gjykuar edhe sipas tabelës (2) kjo do të mbetet një karakteristike e ecurive edhe për vitin 2024. Rritja ekonomike do të mbetet brenda suazave të përmendura të tendencës së ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, siç e parashikojnë edhe institucionet financiare ndërkombëtare. Kjo është nën pritjet dhe përcaktimet e Qeverisë së Kosovës e cila kishte parashikuar një rritje mbi 5% për të tri vitet brenda periudhë 2022-2024 (MFPT, 2023), përkatësisht 4.6. për vitin 2024, parashikim ky i inkuadruar në Draftin e Buxhetit për vitin e ardhshëm. Risqet për një vazhdimësi të këtij ngadalësimi të rritjes lidhin me vazhdimin e luftës në Ukrainë por edhe me ngadalësimin e rritjes në BE e sidomos në Gjermani (Banka Botërore, 2023) që mund të ketë një ndikim më të madh duke marrë parasysh vëllimin e këmbimit tregtar dhe të remitencave.

● **Tabela 2.** Projektionet për rritjen ekonomike në Kosovë

	2023	2024
Baka Botërore	3.2	3.9 ↑
FMN	3.8	4.0 ↑
Instituti wiiw	2.7	3.3 ↑
EBRD	2.0	3.0 ↑
Parashikimet me Buxhetin 2023 (MF)	3.9	4.6 ↑

Burimi: Baka Botërore, FMN, wiiw, dhe EBRD

Një rritje ekonomike që do të kalonte 5% dhe do të afrohej me normën e rritjes 6-7% do të thoshte se ekonomia e Kosovës ka kaluar në një fazë të re cilësore të zhvillimit, për të dalë nga kurthi i deficitit kronik tregtar dhe papunësisë së lartë dhe për të zënë një hap më dinamik të përfarimit me nivelin e zhvillimit të rajonit të BP6 dhe atë të BE<sup>1</sup>. Duket se ende nuk janë krijuar parakushtet për ta rritur këtë kthesë. Është e qartë se Kosova është e mbërthyer brenda një kornize politikash e faktorësh që i sigurojnë vetëm një rritje ekonomike brenda një trendi historik siç provojnë statistikat për më shumë se një dekadë e gjysmë. Rritje kjo që nuk ka arritur të adresojë problemet kyç të zhvillimit ekonomik e social duke konservuar edhe një strukturë të pavolitshme ekonomike (Shtojca 1). Kjo dëshmohet me strukturën thuajse të pandryshueshme të Produktit Vendor Bruto (PVB), ku prodhimi dhe industria përpunuese nuk kanë arritur ndonjë përmirësim të pozitës duke ngelë me një nivel paka a shumë të njëjtë të kontributit në krijimin e PVB. Kjo vlen gjithashtu edhe për ngecjet në sektorët me vlerë të lartë shtuese dhe për sektorin e kërkimeve për zhvillim edhe inovacionet në veçanti. Arritja e një konsolidimi nga pasojat e COVID gjatë vitit 2021 konsiderohej me të drejtë si një mundësi për kthesë më substanciale për një rritje më të shpejtë të bazuar në rritjen e prodhimit dhe eksportit. Mirëpo ecuritë në vitin 2022 dhe 2023, dhe pritjet për vitin 2024 janë kthyer në një variant të ngadalësuar të historikut të rritjes para COVID-19.

Në Kornizën e shpenzimeve afatmesme Qeveria me të drejtë proklamonte se në “periudhën e ardhshme trevjeçare do të fokusohen në riorientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit”. Mirëpo siç do të prezantohet më poshtë kjo nuk është e mbështetur me orientimet e dhëna në Kornizën shpenzimeve afatmesme në intervenimet fiskale dhe buxhetore. Pra nuk ka ende një shikëputje domethënëse. Është krijuar strukturë atipike në shpenzimet qeveritare në dëm të investimeve kapitale e me një pjesëmarrje të madhe të transfereve dhe të asistencës sociale (MFPT, 2023)<sup>2</sup>. Po ashtu investimet e sektorit privat ende nuk përcillen me cilësinë e duhur në aspektin statistikor dhe duket se janë të mbivlerësuara, gjykuar sipas vlerës së pajisjeve të importuara. Ekzistojnë probleme serioze sa i përket efektivitetit në realizmin e projekteve të ndërlidhura me të ash-

1 Shënim: Sipas kategorizimeve të Bankës Botërore Kosova konsiderohet si vend me të ardhura mesatare, nderkaq IMF e kategorizon si vend në zhvillim – ekonomi në zhvillim me PVB për banor prej 14% të mesatares së BE (27% in PPP, pariteti i fuqisë blerëse), përkatësisht rreth 70% të emsates së zhvillimit të Ballkanit Perëndimor;

2 Shënim: Në vitet e fundit, pavarësisht përmirësimeve, nën-ekzekutimi i shpenzimeve kapitale mesatarisht **luhatet rreth 35.0% të vlerave të buxhetuara** (KASH 2024 -2026)

tuquajturën klauzolën e investimeve. Struktura e investimeve të jashtme direkte (IJD) dominohet me peshë më të madhe nga patundshmëritë (BQK, 2023). Ngjashëm edhe struktura e kredisë ende nuk është në funksion të duhur për të mbështetur zhvillimin e ofertës vendore, veçanërisht tek sektorët e industrisë përpunuese me performacë eksportuese. Këtu duhet parë një nga hallkat e kurthit që frenon rritjen ekonomike. Investimet e sektorit privat dhe investimet e jashtme direkte (IJD) mbesin dukshëm prapa potencialit të tyre. Kjo ndikohet edhe nga qasja e limituar në tregjet rajonale dhe globale për shkak të lidhjeve ende të pa konsoliduara të trafikut rrugor dhe hekurudhor, pastaj nga qasja e kufizuar në tregun e kapitalit, furnizimi jo i sigurtë me energji dhe vështirësitë për rekrutimin e fuqisë së kualifikuar punëtore me shkathtësitë e nevojshme. Ndonëse eksporti ka shënuar një rritje dinamike duke u rritur më tepër se dy herë e gjysmë gjatë viteve 2019-2022, deficitit tregtar sa vjen e rritet me një tendencë përqendrimi me 2023 dhe 2024. Ky është frenuesi tjetër i rritjes së qëndrueshme ekonomike. Kështu problemi i mbështetjes së eksportit mbetet ende për tu adresuar seriozisht me një spektër të masave integrale të politikave industriale dhe tregtare në përkim me tregun e hapur.

Situata ekonomike në vend mbetet tepër e lëndueshme nga inflacioni i importuar i ndikueshëm me krizën e shkaktuar nga agresionet në Ukrainë dhe potencialisht edhe se fundi me përqendrimin e situatës në Lindjen e mesme. Kjo vlen sidomos për ndikimet negative të çmimeve të importit për energji dhe ushqim. Me një model të ndryshuar të rritjes ekonomike Kosova do të mund të përshtatej më lehtësisht nga këto rreziqe.

Duke pasur parasysh një sfond të tillë duket tepër optimiste dhe i sforcuar parashikimi i Qeverisë se “në periudhën afatmesme (2024-2026), ekonomia e Kosovës pritet të shënojë rritje reale që qëndron mbi mesataren historike të para-pandemisë, duke u luhatur mesatarisht rreth vlerës 5.8% në terma realë” (MFPT, 2023). Kjo gjithsesi, siç u tha më lartë është më tepër se e nevojshme, por nga dokumentet e publikuara zhvillimore nisur nga Korniza e Shpenzimeve Afatmesme (KASH) nuk duket e mbështetur me një sistem masash dhe politikash të integruara dhe koherente.

### 1.2.1 Modeli ekzistues i politikave ekonomike dhe nevoja për modifikim

Modeli ekzistues i politikave ekonomike i bazuar kryesisht në faktorët e jashtëm si remitencat, kreditë dhe asistencë e jashtme financiare për më shumë se dy dekada nuk ka qenë i përshtatshëm, apo i disenjuar si duhet, për të rritur ofertën vendore veçanërisht industrinë eksportuese dhe shërbimet me vlerë të lartë shtuese. Një mbështetje më domethënëse me Paketë fiskale 1 dhe 2 në vitet 2015 dhe 2016 nuk u vazhduar që të zhvillohet si duhet dhe të përsoset më tej. Si pasojë modeli ekzistues i rritjes ekonomike pothuajse ka harxhuar fuqinë e tij për rritje ekonomike transformuese. Atij po i mungojnë shtytësit zhvillimor dhe më tepër po konservon një gjendje që në teorinë dhe praktikën e zhvillimit njihet si kurthi zhvillimor i vendeve me të ardhura mesatar (Banka Botërore, 2009)<sup>3</sup>. Kjo karakterizon shumicën e vendeve me nivel të ngjashëm zhvillimi e që nuk arrijnë ta zgjidhin me sukses këtë problem. Për të dalë nga një situatë e tillë sugjerohet që të investohet në rritjen e aftësisë konkurruese të ofertës vendore me produkte dhe shërbime, të investohet në inovacione dhe kërkime zhvillimi. Fatkeqësisht Kosova ngele shumë prapa në këtë fushë. Duke ndjekur kriteret e njëjta me rangimin e 142 vendeve të botës në Raportin e konkurrueshmërisë globale të Forumit Ekonomik Botëror (WEF) të Davosit, ku Kosova nuk përfshihet ende, është llogaritur se sa i përket aftësisë për inovacion Kosova rangohet tejet ultë - në vendin e 128 (ASHAK, 2023).

**Ndaj siç kemi theksuar edhe më herët shtrohet një domosdoshmëri për tejkalimin e kësaj situatë nëpërmjet zbatimit të një modeli të ri të rritjes ekonomike që bazohet në politika aktive industriale, forcim të politikave në favor të ofertës konkurruese vendore, përvetësim të dijeve dhe teknologjive të reja (Riinvest, 2017). Kjo do të thoshte një përmirësim i politikave industriale në dobi industrisë përpunuese dhe shërbimeve me vlerë të lartë shtuese si dhe të ashtuquajturave industri kreative<sup>4</sup>. Pikërisht këtë nevojë duhet ta fuqizojë qartas dokumentin e propozuar të Strategjisë Industriale e Kosovës 2023 -2030. Kjo nevojë bëhet urgjente kur kemi parasysh pozitën e pavalitshme të industrive prodhuese e eksportuese**

3 Shënim: Kjo është një situatë kur një vend me të ardhura mesatare (PVB për një banor) ballafaqohet me vështirësi serioze për të kaluar në grupin e vendeve me të ardhura të larta për shkak të rritjes së kostove dhe ngecjes ose rënies së aftësisë konkurruese (Shih me gjerësisht Brenda Grith [library.worldbank.org/doi/epdf/10.1596/9780821387856\\_CH04](http://library.worldbank.org/doi/epdf/10.1596/9780821387856_CH04))

4 Shënim: Sektorët që u identifikuan përmes Procesit të Zbulimit të Sipërmarrësve (EDP) të strategjisë S3, i cili përfshin Industrinë e Përpunimit të Drurit, TIK, Industrinë e Përpunimit të Ushqimit, Energjinë (me fokus në Energjinë e Gjelbër) dhe Industrinë Kreative. Riinvest ka qenë pjesëmarrës aktiv në grupet punuese për hartimin e strategjisë S3.

në kreditim (vetëm rreth 13.3%) dhe pjesëmarrjen në investimet e jashtme direkte (vetëm 1.6%). Një element qensor i modelit të ri duhet të jetë edhe një sistemi i integruar i politikave industriale për nxitjen e eksportit .

Modeli i ri i rritjes ekonomike ekonomik i bazuar në politikat e rritjes së ofertës së produkteve dhe shërbimeve për tregun e brendshëm dhe të jashtëm nënkupton dhe shpenzim më të përgjegjshëm dhe efektiv të fondeve publike sidomos në dobi të një investime më frutdhënës në arsim, shëndetësi dhe kërkime e zhvillim. Me këtë krijohen kushtet afatgjata për të ngritur potencialin për rritje ekonomike të qëndrueshme, sidomos duke u ndërlidhur me angazhimet e pikërisht, shumë të rëndësishme, lidhur me hartimin dhe aprovimin e Strategjisë së Specializimit të mençur (S3), Agjendës së Gjellbër dhe Digjitalizimit. Në kuadër të këtij riorientimi, Kosova domosdo duhet të rritë ndjeshëm investimet publike dhe private në kërkime e zhvillim (R&I) dhe atë dukshëm mbi obligimet ekzistues ligjore ( 0.7%) të Buxhetit. Nuk duket bindës kundërshtimi kësaj nevojë se mundojnë kapacitetet absorbuese. Në vitin 2021 pati mbi 50 aplikime nga Kosova në Programin Horizon Europe . Me modelin e ri të rritjes kërkohet që investimi në kërkime dhe inovacione të arrijnë së paku mesataren rajonale (0. 5% të PVB) për një periudhë 2-3 vjeçare. Kjo mund të tejkalohet edhe në një ambient më të mirë që favorizon politika dhe procedura nxitëse në organizata kërkimore në fakultete, universitete dhe jashtë tyre. <sup>5</sup> Modeli i ri rritjes ekonomike i bazuar në politikat që favorizojnë ofertën konkurruese është rruga e domosdoshme për të zënë hapin e një trendi të ngushtimit të hendekut me BE-në sa i përket të ardhurave si dhe për të frenuar rrjedhën brengosëse të migrimit edhe të ekspertëve thuaja nga të gjitha fushat, ekspertë të edukuar me kapacitete dhe potenciale për kërkime e inovacion.

Pjesë e rëndësishme e kalimit në modelin e ri të rritjes ekonomike është edhe përmirësimi domosdoshëm i politikave fiskale e buxhetore sidomos kur është fjala për investimet në arsim dhe shëndetësi si dhe investimet dhe për kërkime dhe inovacione. Ndërlidhur me këtë është edhe tejkalimi i dobësive dhe ineficiencës së theksuar në realizmin e Programin të investimeve Publike (PIP). Siç do të analizohet edhe më poshtë politikat buxhetore dështojnë seriozisht ta bëjnë këtë për një

kohë të gjatë. FMN në një nga vlerësimet e paradokshme konstaton se “dobësitë në menaxhimin e investimeve publike kanë një peshë të të madhe në cilësinë e të investuarit dhe situatës së përkeqësuar lidhur me këtë (IMF, 2023). Kjo kërkon sipas FMN përmirësimin edhe të strukturës dhe të fuqisë absorbuese të investimeve publike, duke tejkaluar një mori dobësish në menaxhimin e investimeve publike që lidhen me dobësitë tek shpronësimet, prokurimi dhe kontraktimet për ekzekutim dhe sidomos dobësitë në zbatim të kontratave e që rritë koston e investimeve dhe zvogëlon dukshëm efektet e pritura të këtyre projekteve në fazën eksploatimit. Më tutje BB konstaton se në përgjithësi vendimet lidhur me shpenzimet publike nuk janë në linjë të prioriteteve strategjike dhe se “procesi buxhetor mbetet jo i ndërlidhur me performancën” (Banka Botërore, 2023). Problem në vete paraqitet efienca e ultë dhe efektet jo të mira të transfereve dhe subvencioneve duke përfshirë edhe ato në bujqësi dhe ndërmarrjet publike ku thuaja mungon një standard i nevojshëm vlerësimi të projekteve në fazën e aprovimit të tyre kontroll dhe vlerësimi i efekteve ex post – pas realizmit të tyre.

### 1.2.2 Sektori i jashtëm

Tabela 3, ofron një pamje gjithëpërfshirëse të dinamikës tregtare të Kosovës për vitet e fundit, duke përfshirë parashikimet për 2023 dhe 2024. Viteve të fundit eksportet e mallrave shënuan një ngritje të qëndrueshme nga viti në vit duke përjashtuar vitin 2023. Në periudhën janar - gusht pati një rënie të dukshme në krahasim me vitin paraprak, duke e rritur deficitin tregtar për 3,1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Sipas parashikimeve të WIIW (2023), vlera e eksportit të vitit 2023 dhe 2024 do të ngelet para vlerës së eksporteve në 2022, ndërkaq parashikimi për importe parashihet një rritje, të dyja këto që do e thellojnë më tutje deficitin tregtar. Në këtë mënyrë mbulueshmëria e importit me eksport duket se do të pësojë rënie në krahasim me vitin 2022.

5 **Shënim:** Mendime dhe sugjerime rreth Programit Kombëtar të Shkencës (PKSH: Si përpjesë e buxhetit, në tre vitet e ardhshme (aq sa parasheh Korniza Afatmesme e Shpenzimeve), kërkesat e përgjithshme buxhetore për aktivitete e parapara me PKSH janë shumë modeste. Në vitin 2023 kjo përpjesë është 0.32%, në vitin 2024 është 0.49%, ndërsa në vitin 2025 është 0.56%. Si përpjesë e PVB, kërkesat buxhetore për aktivitete e parapara me PKSH në vitin 2023 janë 0.11%, në vitin 2024 janë 0.15%, ndërsa në vitin 2025 0.16% të PVB-së, për dallim nga mesatarja e rajonit rreth 0.5%.

● **Tabela 3.** Statistikat e tregtisë së jashtme (në miliona euro)

	2019	2020	2021	2022	Janar - Gusht 2023	2023 parashikim	2024 parashikim
Eksporti i mallrave	393	475	753	932	495	987	1,184
Importi i mallrave	3,233	3,048	4,320	5,219	3,199	5,421	5,941
Deficiti tregtar	-2,840	-2,573	-3,567	-4,287	-2,704	-4,434	-4,757
Norma e mbulueshmerise se importit në eksport	12%	16%	17%	18%	15%	18%	20%

Burimi: BQK-së 2019-2022, Parashikimi me dokumentet e buxhetit të Kosovës 2023-2024

Në tetë muajt e parë të vitit 2023, importet e Kosovës u rritën lehtësisht për 1.03% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Në një vështrim më të afërt të partnerëve tregtarë shihet se importet nga vendet e CEFTA-s kanë shënuar rënie me 7.59%, nga ana tjetër, importet nga vendet e BE-së dhe me vendet e tjera shënuan një rritje pozitive prej 2.35% dhe 3.47%, respektivisht. Këtë vit Kosova vazhdoi të tërheqë një nivel të konsiderueshëm të importeve nga Gjermania (30%), e cila mbetet në vendin e parë. Ndërkohë, Italia këtë vit zë vendin e dytë me 13% të totalit të importit.

Eksportet e Kosovës, deri në gusht të këtij viti, ranë për afërsisht 7.93% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Në vitin 2023, vendet të cilat Kosova eksporton me vëllim më të madh vazhdojnë të jenë të njëjtat sikur në 2022; Maqedonia e Veriut me rreth 37%, pasuar nga Shqipëria me 32% dhe Serbia me 14%. Eksportet drejt vendeve të BE-së kanë shënuar rënie më të konsiderueshme prej 10.97%. Megjithatë, eksportet drejt shtetit të Gjermanisë u rritën për shtatë pikë të përqindjes në vitin 2023. Me vendet e tjera, eksportet zënë afërsisht 27.8% të totalit të vlerës së eksporteve, krahasuar me 31% sa ishin në vitin 2022, kur prej tyre pjesën më të madhe e mbulojnë Shtetet e Bashkuara dhe Zvicra.

Krahasuar me vitin 2022, kategoritë kryesore të cilat Kosova

i eksporton mbeten të njëjtat. Sipas strukturës sektoriale, vërejmë se mallrat të cilat Kosova i eksporton më së shumti në vitin 2023 janë artikujt e ndryshëm të prodhuar me 18% të totalit të vlerës së eksporteve. Këtu hyjnë mobilieritë, krevatat, dyshekët, mbajtëset e dyshekëve, jastëqet dhe shtresa të ngjashme të mbushura; pastaj vjen plastika dhe artikuj prej saj, me 12% të totalit; dhe në fund metalet bazë (artikuj prej gize dhe çeliku) me 11%.

Nga ana tjetër, mallrat që importohen në vlerë më të madhe në vitin 2023 janë ato nga produktet minerale (lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet për dishtilimit të tyre; substancat bituminoze) me 13%, më pas vijën mjetet e transportit, pjesët dhe plotësuesit e tyre me 10%, dhe si kategori e tretë janë makineritë dhe pajisjet mekanike me 7%. Te kjo e fundit, është e rëndësishme të analizohet veçanërisht niveli i importeve të makinerisë për prodhim<sup>6</sup>, për të analizuar potencialin e rritjes së prodhimtarisë dhe të investimeve. Në tabelën e dhënë, shohim vlerën e makinerisë së importuar duke përfshirë pajisjet e amvisërisë dhe transportit. Një nivel i tillë i importeve të pajisjeve është indikativ për vëllimin e pamjaftueshëm të investimeve në sektorin e prodhimit (Tabela 4).

<sup>6</sup> Shënim: Sipas tarifës së integruar të Doganës së Kosovës, seksioni 16: kapitulli 84 (reaktorët nuklearë, kaldajat/bojlerët), makineritë dhe pajisjet mekanike, pjesët e tyre) dhe kapitulli 85 (makineri dhe pajisje elektrike dhe pjesët e tyre; regjistruarit dhe riprodhuesit e tingullit; regjistruarit dhe riprodhuesit e imazhit televiziv dhe zërit, pjesët dhe plotësuesit këtyre artikujve), duke mos përfshirë pajisjet që nuk hyjnë në prodhimtari.



● **Tabela 4.** Importi i makinerisë dhe paisjeve nëpër vite (në miliona euro)

Viti	Makineri dhe pajisje	Si % e totalit të importit
2021	326.11	7.01 %
2022	292.27	5.22 %
Janar - Shtator 2023	249.87	6.71 %

Burimi: Dogana e Kosovës

Për më tepër, është e rëndësishme të kuptohet se inputet e përdorura për të prodhuar mallrat e eksportuara shpesh importohen. Në raste të tilla, përfitimet ekonomike varen nga vlera e shtuar në këto mallrave të destinuara për eksport. Gjykuar nga struktura e produkteve dhe lëvizjet e deficitit tregtar shihet se niveli i ulët i vlerës së shtuar tek eksportet përbën një nga problemet kryesore. Tabela 5 pasqyron se përkundër eksportit ende të pamjaftueshëm, kontributi

i industrisë përpunuese është në eksporte është i rëndësishëm. Pra, në rastin kur eliminohet lënda e parë si eksport nga Kosova, industria përpunuese vërehet se përbën rreth 38% për qind të bazës së eksportit total. Fakti se ky sektor kontribuon gati tri herë më shumë në vlerën e eksportit se sa në PVB dëshmon për potencialet e këtij sektori dhe nevojën e mbështetjes së tij domethënëse.

● **Tabela 5.** Kontributi i industrisë përpunuese në eksportet e mallrave kosovare, në miliona euro (2019-2022)

Viti	Eksporti i industrisë përpunuese <sup>7</sup>	Si % e totalit të eksportit
2019	156,229	40.7 %
2020	183,755	38.7 %
2021	261,209	34.8 %
2022	355,591	38.6 %

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

7 Shënim: në llogaritjen e madhësisë së industrisë përpunuese në Kosovë janë përfshirë këto eksporte: yndyrërat, ushqime, pije, pije alkoolike dhe duhan, produkte të industrisë kimike, plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, lëkurë dhe artikuj prej tyre, druri dhe artikuj druri, letër dhe artikuj prej letre, tekstil dhe artikuj tekstili, veshmbathje të këmbëve, artikuj prej guri, allçie, produkte qeramike dhe qelqi, makineri, pajisje mekanike dhe elektrike.

Te vlerësimi i rrjedhave të eksportit është më rëndësi të merret në konsideratë raporti vlerë/sasi. Kështu, shihet se ndonëse në vitin 2022 vlera e mallrave të eksportuar ishte më e lartë krahasuar me vitin paraprak, sasia e këtyre mallrave ka qenë më e ulët krahasuar në raport me vitin 2021. Dallimet janë më dukshme në seksionet si “Kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë prej kafshëve” si dhe “Produktet minerale” (Dogana e Kosovës). Vlen të theksohet se rritja e vlerës së eksporteve por jo edhe sasisë pjesërisht i atribuohet ngritjes së çmimeve përgjatë dy viteve të fundit.

Investimet e jashtme direkte (IJD) u rritën 14% në gjysmën e parë të 2023, kjo u nxit kryesisht nga investimet turke. Partnerët e tjerë të mëdhenj të Kosovës – si BE dhe SHBA – kanë shkurtuar flukset hyrëse të IJD-ve. Në veçanti, partnerët kryesorë investues – Gjermania dhe Zvicra – kanë reduktuar hyrjet e tyre të IJD-ve në Kosovë për 7% dhe 4%, respektivisht, ndërsa IJD-të nga SHBA janë pothuajse përgjysmuar. Ky skepticizëm i investitorëve të huaj pjesërisht mund ta ketë burimin edhe në tensionet politike në vend.

● **Tabela 6.** Stoku Investimet e jashtme direkte në Kosovë (në miliona euro) sipas aktivitetit ekonomik, kumulativ dhe si % e totalit – (Janar 2019 – Gusht 2023)

	Total IJD 2019- Gusht 2023	Si % e totalit
<b>Aktivite të patundshmërisë</b>	1646.7	72.6
Aktivite financiare dhe të sigurimit	283.2	12.5
Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	76.6	3.4
Xehetaria dhe guoret	51.3	2.3
Ndërtimtari	43.6	1.8
Informatikë dhe komunikim	39.9	1.8
Prodhim	36.6	1.6
Të paspecifikuara	32.5	1.4
Aktivite profesionale, shkencore dhe teknike	28.8	1.3
Aktivite administrative dhe mbështetëse	11.5	0.5
<b>Total</b>	<b>2267.0</b>	<b>100%</b>


Burimi Banka Qendrore e Kosovës

Krahas nivelit të investimeve të jashtme, problemi qenësor ndërlidhet edhe me sektorët në të cilët është investuar. Tabela më lartë ilustron një gjendje jo të favorshme, ku listës i paraprijnë investimet në patundshmëri (73%), investime këto të cilat nuk paraqesin potencial për multiplikim të ndikimit ekonomik. Në anën tjetër ky nivel IJD-ve në industrinë prodhuese (1.6%), është shqetësues. Investimet jashtme në Kosovë deri më tani nuk ngjajnë të jenë në sektorë që nxisin zhvillimin ekonomik, e posaçërisht jo në sektorët e prodhimit industrial - sektori kyç i zhvillimit të potencialit eksportues.

Remitancat janë kategoria kryesore në kuadër të të ardhurave dytësore, vlera e të cilave deri në korrik 2023 shënoi 753.9 milionë euro, që paraqet rritje prej 84 milionë euro ose 12% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Efek-

tet pozitive janë evidente, kryesisht gjatë sezonit të verës kur numër i madh mërgimtarësh vizitojnë Kosovën, gjë që përkthehet në vëllim më të madh shitjesh për bizneset. Gjithashtu, remitencat pothuajse plotësisht përdoren për të financuar konsumin dhe deficitin tregtar, gjë që nuk i ka ndihmuar aftësisë konkurruese. Ky model i financimit e ka mbajtur ekonominë kosovare në një rrugë të kufizuar të rritjes së konkurrencës dhe mund të ndryshohet me politika që riorientojnë remitencat drejt aktiviteteve më produktive. Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm të remitancave në stimulimin e sektorit të shërbimeve, politikat që synojnë kanalizimin e tyre, mbështetjen e investimeve në arsim dhe ndërmarrësi, dhe nxitjen e një mjedisi të favorshëm për diversifikimin ekonomik mund të rrisin më tej kontributin e sektorit të shërbimeve.

● **Figura 1.** . Dërgesat e migrantëve ndër vite (në miliona euro)



● **Tabela 7.** Eksporti dhe importi i shërbimeve ndër vite (në miliona euro)

Viti	2019	2020	2021	2022	Janar - Qershor 2023
Eksporti i shërbimeve	1,675	995	1,906	2,503	1,089
Importi i shërbimeve	749	603	871	1,127	536

Burimi Banka Qendrore e Kosovës

Kosova konsiderohet të jetë ekonomia më e hapur për tregti në shërbime në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Krahasuar me ekonomitë e OECD-së, ajo është gjithashtu një nga më tërheqëset për sa i përket mungesës së kufizimeve ndaj ofruesve të shërbimeve (OECD, 2021). Hapjes më e madhe e tregtisë në shërbime mund të përmirësojë efikasitetin dhe produktivitetin e firmave vendase. Sipas Buletinit Ekonomik i MFPT për tremujorin e parë të vitit 2023, rritja pozitive e eksporteve të shërbimeve i shërbeu në masë të madhe rritjes ekonomike në vend. Veçanërisht, në vitin 2022 u shënuar një rritje prej 30.5% e eksporteve të shërbimeve krahasuar me vitin paraprak. Për më tepër, sipas parashikimeve të WIW, trend rritës pritet edhe për këtë vit. Sektorët kryesorë të ekonomisë që mbështetën rritjen ishin sektori i informatikës dhe komunikimit, ndërtimi dhe tregtia me shumicë dhe pakicë.

Sektori i teknologjisë informative dhe komunikimit, ka vite që kontribuon dukshëm në eksportet e shërbimeve dhe ka potencial të fortë për rritje të mëtejshme. Megjithëse vendi posedon disa avantazhe krahasuese në rritjen e një industrie të ICT të orientuar nga eksporti, ky treg është ende i vogël dhe i pazhvilluar për shkak të nivelit të ulët të digjitalizimit, kjo për shkak të numrit të pamjaftueshëm të punëtorëve të kualifikuar, bashkëpunimi i dobët midis sektorit dhe institucioneve përkatëse arsimore dhe mungesa e qasjes në financa, veçanërisht për bizneset fillestare.

Gjithsesi, për të përballuar këto sfida, Kosova duhet të kujdeset për diversifikimin e ekonomisë dhe promovimin e sektorëve me potencial rritjeje. Kjo duhet të fillojë me identifikimin e sektorëve që kanë trend dhe potencial rritës, dhe të pasohet me dizajnin e politikave ekonomike të cilat stimulojnë zhvillimin e këtyre sektorëve dhe promovojnë investimet sidomos nga sektori privat. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të vërehet se ndërsa eksporti i mallrave mund të paraqesë sfida në rritjen e tij, sektori i shërbimeve ofron potencial dhe mundësi të dukshme. Megjithëse sektori i shërbimeve tanimë ka një bilanc pozitiv të përgjithshëm, ende ka hapësira për rritje të mëtejshme. Politikëbërësit duhet të

marrin në konsideratë inkurajimin e inovacionit, përmirësimin e përfshirjes financiare dhe mbështetjen e ndërmarrjeve. Këto hapa do të ndihmojnë në rritjen e konkurrueshmërisë së vendit dhe në zhvillimin e një ekonomie më të qëndrueshme dhe të diversifikuar.

### 1.2.3. Sektori Financiar

Sektori financiar në Kosovë, i dominuar nga bankat komerciale, vazhdon trendet e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë. Në pikëpamje strukturore, dominimi i bankave me kapital të huaj (rreth 85% e tregut bankar), me teknologjinë dhe dijen e nevojshme për banking modern, dhe një mbikëqyrje proaktive nga BQK, ka qenë një faktor determinues i suksesit në sektor. Vitin që lamë pas, sektorit bankar i është shtuar një bankë me kapital vendor dhe dy institucione financiare jobankare. Numri i degëve dhe i të punësuarve në sektor ka vazhduar trendin e rritjes, përkundër avancimeve në digjitalizim. Që nga koha e pandemisë, janë dyfishuar pagesat në e-banking dhe terminale të shitjes, si për nga numri i transaksioneve ashtu edhe për nga shuma.

Sektori financiar mbetet mirë i kapitalizuar, profitabil dhe likuid. Për shembull ROA dhe ROE në sektorin bankar prej 2.6% dhe 21% respektivisht, tregojnë një kthim solid. Likuiditeti prej 33% (asetet likuide në raport me detyrimet afatshkurtëra), dhe raporti kredi-depozita prej 81%, kredi joperformuese prej vetem 2%, kapitalizim prej rreth 15%, tregon një performancë të jashtëzakonshme të sektorit bankar. Edhe sektorët tjerë financiar janë karakterizuar me performancë të mirë. Për shembull, kompanitë e sigurimeve kanë përmirësuar performancën, sidomos në kapitalizim. Institucionet mikrofinanciare kanë vazhduar rritjen e kreditimit, kryesisht për ekonomitë familjare, me një pjesëmarrje prej më pak se 10% në totalin e kredive të sektorit financiar.

Kreditimi në sektorët e ekonomisë vazhdon trendet organike. Kreditë kanë shënuar një rritje vjetore prej afër 14%, në terma

nominal – ku inflacioni këtë rritje e neutralizon në terma real. Edhe depozitat kanë shënuar rritje prej 11.3%. Në strukturë, kreditë për ekonomitë familjare marrin pjesë me 37%. Në anën tjetër, kreditë për firmat vazhdojnë të kenë strukturë të ngjajshme, e që pasqyrojnë edhe strukturën e ekonomisë. Për shembull, kreditë në sektorin e bujqësisë kanë një pjesëmarrje prej 2%, industri, energji dhe ndërtim 36%<sup>8</sup>, dhe shërbimet 62%, një trend pothuaj konsistent. Sipas maturitetit, struktura e kredive në vitet e fundit ka mbetur poashtu e njëjtë, ku kreditë me maturitet deri një vit marrin pjesë me 15%, ato me maturitet 1-5 vite me 45% dhe ato me maturitet mbi 5 vite me 40%. Sidoqoftë, nëse krahasojmë me dhjetë vite më parë, pjesëmarrja e kredive afatgjata (Smbi 5 vite) është dyfishuar dhe atyre afatshkurtëra (deri 1 vit) është përgjysmuar. Kredia në sektorin privat në raport me PVB prej afër 50% mbetet në nivele relativisht të ulëta, nëse krahasojmë me eurozonën. Sidoqoftë, ky tregues është në mesataren e rajonit të Ballkanit Perëndimor, ku Kosova qëndron më mirë krahasuar me Shqipërinë dhe Serbinë.

Normat e interesit pas një periudhe të gjatë të trendeve të favorshme, pjesërisht të determinuara nga ecurite e kushteve monetare globale dhe performanca e sektorit financiar në vend, duket që kanë ndërprerë këtë trend. Në perspektivë, mund të pritet që kushtet e kreditimit do të vështirësohen, ku prospektet e ecurive monetare (por edhe fiskale) globale japin indikacion të tillë. Normat e interesit kanë pësuar rritje të vogël, në kredi dhe depozita, por margjina e interesit mbetet pothuaj e njëjtë krahasuar me vitin paraprak. Rritja e çmimeve dhe nevojat për likuiditet mund të rrisin nevojën për kreditim. Shtrëngimi potencial i kushteve të kreditimit, normat e interesit në kredi, si dhe kthimi në letrat me vlerë të qeverisë, pritet të kenë presion për rritje. Kështu, mund të vështirësojë qasjen në financa, me implikime negative në konsum e investime. Që nga pandemia, stoku i kredive me norma variable të interesit është dyfishuar, duke arritur në 30%. Rrjedhimisht, ecuritë e normave të interesit në tregje ndërkombëtare si ajo Euribor, do të kenë implikime në tregun financiar në Kosovë.

Ekspozimi i sektorit financiar ndaj sektorit të jashtëm mbetet i lartë. Asetet e jashtme neto pothuaj kanë arritur shumën prej €4 miliardë, apo 45% e PVB-së, ku Fondi i Kursimeve Pensionale (Trusti) merr pjesë me 1/2 e vlerës, e pasuar nga BQK dhe

bankat komerciale. Kontribues në rritjen vjetore të aseteve të jashtme neto prej 13%, bankat komerciale janë kontribuesi kryesor, pasuar nga Trusti, ku pozicioni i BQK-së mbetet pothuaj pandryshuar. Në anën tjetër, kërkesat e sektorit financiar (kryesisht Trusti dhe bankat komerciale) ndaj qeverisë qëndrore kanë shënuar rënie prej rreth €150 milion.

Ekspozimi mjaft i lartë i sektorit financiar ndaj tregjeve ndërkombëtare (edhe pse mirë i diversifikuar) të cilat po reflektojnë risqe në shumë dimensione, implikon një domosdoshmëri të fuqizohet parimi i sigurisë, i etabluar në politikat investive të institucioneve financiare (p.sh. BQK dhe Trusti). Kështu, duke subordinuar principin e kthimit në asete për një shkallë domethënëse, për një periudhë së paku afatshkurtër. Për shembull, një rritje e ekspozimit të aseteve të Trustit në formën e letrave me vlerë të Qeverisë dhe depozitave në tregun financiar në Kosovë mund të jetë e dëshirueshme.


#### 1.2.4. Shpenzimet qeveritare – Buxheti

Buxheti i Kosovës mbetet një nga instrumentet kryesore të politikave ekonomike përmes së cilit Qeveria mbështet zhvillimin e sektorëve të ndryshëm. Bazuar në parashikimet e Qeverisë së Kosovës (MFPT, 2023) të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore për vitet 2023 dhe 2024 pritet të ndjekin një trend rritës ngjashëm me vitet e kaluara. Të ardhurat për vitin 2023 parashihen të arrijnë vlerën e rreth 2.8 miliardë euro ose rreth 390 milion më shumë krahasuar me vitin 2022<sup>9</sup>. Kjo rritje e të ardhurave buxhetore vjen kryesisht nga rritja e të hyrave nga Tatimi i Vlerë së Shtuar (TVSH) e që është edhe rezultat i rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe formalizmit të ekonomisë. Nga ana tjetër, shpenzimet buxhetore për vitin 2023 pritet të jenë rreth 3.3 miliardë euro ose 680 milion euro shumë krahasuar me 2022. Deficiti buxhetor pritet të jetë – 3.6 % të BPV-së. Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2024 pritet të jetë përafërsisht e njëjtë krahasuar me vitin paraprak, të ardhurat janë parashikuar të arrijnë vlerën e 3.02 miliardë euro ndërsa shpenzimet në 3.3 miliardë euro (MFPT, 2023).

8 Shënim: në kuadër të kësaj kategorie, kreditë e bankave në sektorin e industrisë kanë arritur vlerën në rreth €580 milionë, me një rritje vjetore prej 13%, duke mos ndryshuar strukturën e kreditimit të sektorit bankar në këtë kategori për një periudhë shumëvjeçare. Në raport me stokun e kredive, kreditë në sektorin e industrisë përfaqësojnë rreth 13.3%.

9 Shënim: Bazuar në raportin financiar nëntëmujor të thesarit, të hyrat buxhetore për vitin 2023 janë 75 % të planit vjetor të parashikuar. Të hyrat e mbledhura nga Dogana e Kosovës kanë arritur vlerën bruto prej 1.202.42 milionë euro, apo 72% e planit buxhetor për vitin 2023. Ndërsa, të hyrat e mbledhura nga Administrata Tatimore e Kosovës kanë arritur vlerën bruto prej 644.18 milionë euro, apo 72% e planit buxhetor për vitin 2023. Për më shumë: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1675633B-7E7D-4FEA-9803-7DFDD4CE5FE0.pdf>

● **Figura 2.** Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore




Burimi: MFPT: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024 – 2026 dhe Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024

Burimi kryesor i të ardhurave rreth 75 përqind vjen nga tatimet indirekte, përkatësisht mbledhjes së TVSH-së. Krahasuar me vitet e tjera, vërehet një rritje e njehershme e mbledhjes së TVSH-së në vend si rritje e akcizës për mallrat e importuara e cila vjen nga rritja e vlerës së importeve të mallrave, e ndikuar nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Nga ana tjetër edhe tatimet direkte janë rritur krahasuar me vitin paraprak duke i falënderuar një trendi të zvogëlimit të informalite-

tit në vitet e fundit si dhe rritjes së inflacionit. Specifike për vitin 2023 është një rritje e theksuar në kategorinë e granteve dhe ndihmave në vlerën prej 97.5 milion euro e që përbëhet nga grantet e BE-së për të mbështetur sektorin energjetik dhe për Menaxhimin e financave publike (MFPT, 2023). Të hyrat jo-tatimore mbetet përafërsisht në strukturën e njëjtë krahasuar me vitet e kaluara duke mbuluar afërsisht 9 përqind të ardhurave të përgjithshme.

● **Figura 3.** Struktura e të ardhurave buxhetore




Burimi: MFPT: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024 – 2026 dhe Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.

### 1.2.4.1. Struktura e Shpenzimeve Buxhetore

Për periudhën nëntë mujore (Janar – Shtator 2023) është shpenzuar rreth 55 përqind e buxhetit ose 1,820 miliardë euro (MFPT, 2023). Shpenzimet për kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë planifikuar të arrijnë vlerën e 745.5 milionë euro në vitin 2023, që paraqet një rritje 11 përqind krahasuar me vitin 2022. Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së koeficientit në ligjin e ri të pagave për zyrtarët publik. Ndërsa shpenzimet për subvencione dhe transfere pritet të kalojnë mbi 1 miliard në vitet e ardhshme. Kjo rritje e konsiderueshme dhe sidomos në raport me vitin 2021, paraqet një riorientim gradual të politikave publike drejt mbështetjes sociale me iniciativat e fundit të Qeverisë. Pjesëmarrja kaq e lartë e shpenzimeve rrjedhëse në buxhetin e

përgjithshëm tregon për një shpërpjesëtim në strukturën e destinimeve të buxhetit. Ndonëse këtë vit kemi një rritje të shpenzimeve kapitale prej 16.4 përqind në krahasim me vitin paraprak, realizimi i projekteve kapitale është në nivele shumë të ulta. Bazuar në raportin financiar nëntë mujor të thesarit shpenzimet kapitale arritën vlerën prej 263.7 milionë euro, që paraqet një normë të ekzekutimit afërsisht 29 %krahasuar me vlerën totale të buxhetuar për këtë kategori. Pavarësisht arsytimit të qeverisë se projektet kapitale po realizohen me vështirësi për shkak të mos funksionalizimit të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), mosmarrëveshjeve pronësore, anulimit të kontratave me çmim fiks nga operatorët ekonomik për arsye të inflacionit, këto janë çështje në kompetencë të vet qeverisë dhe si të tilla duhet të adresohen me kohë.

● Figura 4. Struktura e shpenzimeve buxhetore



MFPT: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024 – 2026 dhe Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.



Destinimi i shpenzimeve përkatësisht parasë publike në sektor të caktuar pasqyron prioritetet e politikave qeveritare. Për të nxjerrë përfundime kjo duhet trajtuar për një periudhë më të gjatë, së paku afatmesme. Tabela 8 ilustron këto lëvizje që nga viti 2019, pra një periudhë 5 vjeçare. Në këtë aspekt shihet një prioritet të sektori mbrojtjes, qeverisja e përgjithshme, mbrojtja sociale dhe rendi dhe ligji. Ndërkaq dinamika e rritjes së shpenzimeve për çështjet ekonomike, arsim dhe shëndetësi dhe pesha e pjesëmarrjes së tyre në destinimet buxhetor është dukshëm e pamjaftueshme. Përkundër prioritetëve të deklaruar mbetet e pamjaftueshme dhe jo në favor të zh-

villimit ekonomik të vendit përkatësisht rritjes më të shpejtë ekonomike. Edhe pse qeveria ka premtuar se këto fusha janë prioritet, ato nuk duken se nuk do të mbështeten në mënyrë adekuate me mjete buxhetore. Afërsisht 30 përqind e buxhetit ose 731 milion euro do të shpenzohet për mbrojtjen sociale. Sektori i shëndetësisë edhe arsimit mbeten me buxhetime të ulta e me dinamik më të ngadalshme të rritjes. Ndonëse shëndetësia do ketë një rritje të buxhetit për 49 përqind krahasuar me vitin 2019 ato mbesin të ulta me rreth 3.5 përqind të BPV<sup>10</sup> dukshëm më e ultë se vendet e rajonit dhe BE.

● **Tabela 8.** Korniza e shpenzimeve sektoriale në nivel qendror (milion euro)

	2019	2024 Parashikimi	Përqindja e rritjes/ zvogëlimit 2024/2019
Qeverisja e përgjithshme publike	209.70	369.8	76%
Sektori i mbrojtjes	58.60	152.1	160%
Rendi, ligji dhe siguria publike	203.90	314.5	54%
Çështjet ekonomike	445.80	360.5	-19%
Mjedisi	55.30	74.9	35%
Çështjet e banimit dhe komunitetit	10.50	6.8	-35%
Shëndetësia	169.70	252.2	49%
Rekreacioni, kultura dhe religjioni	64.20	77.4	21%
Arsimi	110.80	132.9	20%
Mbrojtja sociale	466.60	731.7	57%

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020 – 2022; Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024 – 2026;

10 Shënim: Sipas të dhënave të Eurostat, mesatarja e BE-së për shpenzimet publike në shëndetësi është 8.8 %, ndërsa në vendet e rajonit; Bosnje dhe Hercegovine 6.9 përqind, Serbi 5.7 përqind, Shqipëria 3.4 përqind (%).

Rritja e të ardhurave buxhetore detyrimisht përcjell edhe rritjen e shpenzimeve nëpër kategori të ndryshme. Bazuar në tabelën 9 mund të shihet një strukturë jo shume e përshtatshme. Ekziston një shpërpjesëtim tepër i madh kategorisë subvencione dhe transfere dhe investime kapitale. Buxheti për paga dhe mëditje nga viti 2019 deri në vitin 2024 ka një rritje prej 185 milion euro ose rreth 24.5 % e buxhetit të përgjithshëm. Kjo rritje kryesisht është për të akomoduar rritjen e pagave në sektorin publik. Rritja më e madhe e shpenzimeve është në kategorinë e subvencioneve

dhe transfereve dhe atë nga rreth 600 milion euro (2019) projektohet të arrijnë në 1.1 miliard në vitin 2024 ose rreth 32.4 përqind e shpenzimeve të përgjithshme. Shqetësuese mbeten shpenzimet për investime kapitale, ku nga vitin 2019 në vitin 2024 kemi thujse të njëjtin nivel të projektuar nga 788 milion në 859 milion ose 8.9 përqind rritje brenda intervalit kohor pesë vjeçar. Kur kësaj i shtohet realizmi dobët i investimeve kapitale del qartazi se kjo është fusha ku nevojiten intervenime serioze.

● **Tabela 8.** Korniza e shpenzimeve sektoriale në nivel qendror (milion euro)

	2019	2024 Parashikimi	Përqindja e rritjes/ zvogëlimit 2024/2019	Pjesëmarrja e kategorive në shpenzimet e përgjithshme
Paga dhe Mëditje	619,9	805,4	29,9%	24,5%
Mallra dhe Shërbime	307	518,9	69,0%	15,8%
Shpenzime Komunale	29,4	36,4	24,1%	1,1%
Subvencione dhe Transfere	600	1.062,3	77,1%	32,4%
Shpenzime Kapitale	788,8	859,2	8,9%	26,2%

Burimi: MFPT: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024 – 2026 dhe Projektligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.

#### 1.2.4.2. Analiza e Borxhit Shtetëror

Portofolio e përgjithshme e borxhit shtetëror të Kosovës është ende në nivele të qëndrueshme dhe në kuadër të rregullave fiskale dhe ligjit për borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore i cili thekson se borxhi publik nuk duhet të kalojë më shumë se 40 përqind e BPV (Kuvendi i Kosovës, 2022). Struktura e borxhit të Kosovës në fund të vitit 2022 përbëhet nga borxhi i brendshëm 63 përqind dhe borxhi i jashtëm 37 përqind dhe dy garancitë shtetërore të cilat në tersi përbejnë 20 përqind e BPV ose 1.7 miliardë euro.

Borxhi i brendshëm kryesisht përbehet nga Emetimi i Bonove të Thesarit, Obligacionet Qeveritare dhe letrat me vlerë. Sipas parashikimeve të qeveris deri në fund të vitit 2024 kjo komponente e borxhit publik do të arrijnë vlerën e 1.3 miliardë euro ose 56.3 përqind e borxhit të përgjithshëm. Ai ka të bëjë me borxhin ndaj institucioneve financiare vendore, ku afërsisht 49 përqind e borxhit është tek fondet pensionale; 25 përqind në bankat komerciale; 19 përqind institucionet publike, 4 përqind kompanitë sigurimeve dhe 2 përqind të tjera. Gjithashtu, qeveria planifikon të vazhdojë me përgatitjen për emetimin e obligacioneve në tregun e jashtë – Eurobond. Meqenëse është pozitive që më shumë se gjysma e borxhit të përgjithshëm është i brendshëm, është brengosëse që ky borxh është duke u përdorur për të mbuluar deficitin buxhetor në destinimin e mallrave e shërbimeve dhe transfereve (MFPT, 2023) e jo edhe financimin e investimeve kapitale. Qeveria duhet t'i kushtojë një vëmendje më të madhe dinamikës, strukturës dhe destinimeve të borxhit të brendshëm pasi që në të kundërtën me trendin e tashëm mund të sfidojë stabilitetin buxhetor të vendit në një horizont kohor afatmesëm e sidomos afatgjatë. Ndaj do të ishte e dobishme që dinamika e letrave me vlerë dhe interesi i paguar për letrat me vlerë me maturim më të gjatë se dy vjet të lidhet më shumë me dinamikën e rritjes së PVB-së dhe burimeve primare të të ardhurave të buxhetit të vendit (Riinvest, 2019).


Borxhi i jashtëm në fund të vitit 2022 ishte 641 milion euro i cili ka shënuar rritje prej 11 përqind krahasuar me vitin

paraprak. Ky borxh, është tek organizatat financiare ndërkombëtare kryesisht tek Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (Banka Botërore) 34.08 përqind, BNRZh me 15.9 përqind, Bashkimi Europian me 15.6 përqind dhe FMN me 8 përqind. Borxhi i jashtëm është huazuar me qëllim të financimit të projekteve në fushën e arsimit, bujqësisë, kadastrës, energjisë, shëndetësisë, trajtimit të ujërave të zeza, ngrohjes qendrore, rehabilitimit të rrugëve dhe hekurudhave (MFPT, 2023). Megjithatë situata lidhur me dinamikën e zbatimit të projekteve të ndërlidhura me borxhet e kontraktuara është brengosëse. Bazuar në raportin vjetor të auditimit për borxhin e jashtëm, shtatë (7) projekte/kredi<sup>11</sup> në vlerë totale prej 177 milion euro të ratifikuara për shfrytëzim përgjatë viteve 2017 deri 2022, nuk janë tërhequr fare mjetet financiare, ndërsa kreditë e ratifikuara gjatë viteve 2014 - 2020, të cilat kishin afat përmblylje gjatë viteve 2021 deri 2023, niveli i shfrytëzimit deri në fund të 2022 ishte vetëm 74 nga 174 milion<sup>12</sup>. Kjo situatë është mjaft shqetësuese dhe shtrton nevojën për transparencë dhe llogaridhënie, fillimisht nga qeveria dhe nga agjencitë e zbatimit të projekteve të financuara nga kreditë (Riinvest, 2019). Hyrja në marrëveshje të kredive dhe vonesat në tërheqjen e fondeve në dispozicion, është pasojë e planifikimit të dobët, procesit të shpronësimit dhe mungesës së kapaciteteve qeveritare për t'i shfrytëzuar në kohë dhe në mënyrë efektive fondet e huamarrjes. Si pasojë e këtyre mangësive, Qeveria në vazhdimësi është duke paguar tarifë të zotimit për këto kredi të pashfrytëzuara. Pavarësisht të gjitha këtyre shqetësimeve me shfrytëzimin e borxhit shtetëror, nga viti 2023 dinamika e rritjes së borxhit shtetëror do të jetë shumë e theksuar. Bazuar në Programin e Borxhit Shtetëror (MFPT, 2023). Në fund të vitit 2024 borxhi do të arrijë në 2.7 miliardë euro ose 25, 4 % e BPV. Kjo rritje kaq e lartë e borxhit kërkon një vëmendje të shtuar të Qeverisë dhe akterëve tjerë lidhur me kapacitetin absorbues të Kosovës për ta transformuar këtë borxh në rritje ekonomike dhe mirëqenie sociale, duke i kontribuar cilësisë së jetës dhe rritjes së qëndrueshme afatmesme dhe afatgjata si dhe stabilitetit makroekonomik dhe fiskal.

11 Shënim: Kreditë e ratifikuara të cilat nuk kishin disbursim të mjetëve deri në fund të 2022: (i) Projekti Trajtimi i ujërave të zeza në Prishtinë (ii) Projekti i Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjiçan (iii) Projekti për Masat e Energjisë Efiçente në komunat: Prishtinë, Gjakovë dhe Gjiçan, (iv) Projekti Reagimi i Kosovës ndaj pandemisë COVID -19 për NVM-të, (v) Projekti i Impianti i Ujërave të Zeza në Mitrovicë, (vi) Projekti i Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Mitrovicë, (vii) Projekti Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit.

12 Shënim: Kreditë e ratifikuara të cilat kishin vonesat në disbursimin e mjetëve deri në fund të 2022: Projekti i Zgjerimit të Magjistrals M2 Milloshevë-Mitrovicë, (ii) Projekti për Magjistralen Prishtinë-Mitrovicë (iii) Projekti për Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale, (iv) Projekti Financim shtesë për Projektin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, (v) Projekti për Patundshmëri dhe Infrastrukturë Gjeo-hapësinore, (vi) Projekti për Konkurrueshmëri dhe Gatishmëri për Eksport. (vii) Projekti i Ekonomisë Digjitale të Kosovës, (viii) Projekti Rehabilitimi i Linjës së 10-të Hekurudhore.

● **Figura 5.** Struktura e borxhit shtetëror të Kosovës



Burimi: Programi i Borxhit Shtetëror (MFPT, 2023)

**MJEDISI BIZNESOR**



Ky kapitull paraqet në mënyrë përmbledhëse sfidat e ambientit biznesor ndër vite si dhe eksploron rolin kritik që luan një mjedis biznesor në zhvillimin e sektorit privat në Kosovë, me fokus në ndikimin e tij në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, inovacionin dhe konkurrencën.

Sektori privat në përgjithësi dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) në veçanti luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mirëqenien socio-ekonomike të vendit pasi ato gjenerojnë numrin më të madh të vendeve të reja të punës dhe paraqesin shtyllën kurrizore të ekonomisë vendore. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), aktualisht ato së bashku me bizneset mikro përbëjnë rreth 99% e të gjitha bizneseve në vend.

Pavarësisht sfidave të shumta me të cilat sistematikisht është përballur sektori privat në Kosovë përgjatë dy dekadave të fundit, nuk kanë munguar përpjekjet institucionale në funksion të përmirësimit të ambientit biznesor në vend. Të dhënat nga raportet dhe analizat e ndryshme viteve të fundit shpërfaqin një përmirësim sa i përket sentimentit të bizneseve në Kosovë lidhur me gjendjen e përgjithshme ekonomike në vend (Balkan Barometer, 2022). Megjithatë, mungesa e stabilitetit politik, sfidat me sundimin e ligjit, konkurrenca jo fer, e shumë faktorë të tjerë kanë zvogëluar dukshëm potencialin zhvillimor në Kosovë. Gjithashtu, potenciali për të tërhequr investime të huaja mbetet ende i kufizuar kryesisht për shkak të mos adresimit të mjaftueshëm të disa çështjeve strukturore, duke përfshirë ndërhyrjet politike në ekonomi, nivelin e korrupsionit, pasigurinë energjetike, nivelin e lartë të informalitetit e gjithashtu edhe mungesën e zbatimit të kontratave.

Ky kapitull paraqet në mënyrë përmbledhëse sfidat e mjedisit biznesor ndër vite si dhe eksploron rolin kritik që luan një mjedis biznesor në zhvillimin e sektorit privat në Kosovë, me fokus në ndikimin e tij në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, inovacionin dhe konkurrencën.

## 2.1 Barrierat në mjedisin biznesor ndër vite

Ndikimi i barrierave biznese në zhvillimin e sektorit privat dhe prosperitetin ekonomik është pa mëdyshje i thellë. Këto pengesa, duke filluar nga kornizat komplekse të rregullatorëve, stabiliteti politik, konkurrenca, deri te kufizimet e lidhur me kapitalin, krijojnë një mjedis ku vështirësohen dukshëm përpjekjet sipërmarrëse dhe pengohet rritja organike e bizneseve. Burokracitë e mëdha dhe kërkesat e rrepta të pajtueshmërisë jo vetëm që implikojnë kosto të tepruara për ndërmarrjet, por gjithashtu veprojnë si pengues duke ngulfatur inovacionin. Për më tepër, barrët financiare, të manifestuara përmes qasjes së kufizuar në kapital, përkeqësojnë gjendjen e bizneseve në zhvillim, duke penguar aftësinë e tyre për të investuar, zgjeruar dhe kontribuar në mënyrë thelbësore në strukturën ekonomike. Andaj, përmirësimi i klimës biznese - përfshirë aspektet ligjore, financiare, rregullatore dhe institucionale – përmes fuqizimit të sundimit të ligjit dhe politikave të favorshme për sektorin privat, është hap tejet i rëndësishëm drejt rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Instituti Riinvest në mënyrë sistematike ka bërë vlerësimin e ambientit biznesor përmes aktiviteteve hulumtuese dhe anketave me bizneset në Kosovë. Në vijim janë të përmbledhura rezultatet nga anketat e rregullta të Institutit Riinvest që nga viti 2000 për një mori indikatorësh dhe pengesash me të cilat janë hasur bizneset në Kosovë. Tabela 10 reflekton perceptcionin e bizneseve për 25 indikatorë të ndryshëm dhe intensitetin e tyre ndër vite. Ngjyrat në tabelë reflektojnë ndikimin në të bërit biznes nga perspektiva e bizneseve për secilën barrierë, ku ngjyra e gjelbër nënkupton barrierë me intensitet të ulët ndërsa ajo e kuqe të kundërtën.<sup>13</sup>

13 Shënim: Intensiteti i secilit indikator (barrierë) është matur përmes një shkalle intensiteti nga 0-100 ku 0 nënkupton që çështja apo indikator i caktuar nuk konsiderohet si pengesë ndërsa vlera prej 100 pikë intensiteti paraqet pengesë shumë të madhe në të bërit biznes.

● **Tabela 10.** Barrierat në të bërit biznes (2000-2023)

Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2007	2011	2012	2013	2017	2023
Normat Tatimore	60.5	65.9	66.9	74.7	71.1	75.5	74.7	47.3	62.1	76.1	57.3	63.7
Ngarkesat administrative	41.1	51.6	55.8	64.1	64.3	66.5	65.5	-	-	-	54.3	63.5
Ligjet dhe sistemi gjyqësor	89.2	80.7	73.9	61.5	64.1	66.5	60.8	60.5	68.2	77.7	52.8	55.4
Qasja në kredi	69.5	61.4	63.3	61.9	59.9	55.5	59.8	55.0	60.5	65.3	50.7	58.0
Kostoja e financimit	-	-	-	-	-	-	56.6	56.2	66.7	85.0	56.5	63.5
Potencialet e kufizuara të ndërmarrjes	48.8	48.7	51.2	46.7	50.4	42.0	46.0	-	-	-	45.9	57.5
Aftësitë menaxhuese	29.6	30.0	28.3	29.9	29.2	26.6	28.9	-	-	-	36.9	53.7
Sigurimi i lëndës së parë dhe pajisjeve	50.4	48.7	44.3	44.1	45.7	41.6	38.9	-	-	-	41.8	59.2
Tregu i vogël (kërkesa e vogël)	41.4	50.1	55.0	63.3	60.5	55.4	57.0	-	-	69.8	61.3	65.7
Qasja në informacione për ndërmarrjen	59.1	57.0	50.5	50.6	52.3	51.3	53.4	-	43.0	-	37.1	55.3
Inkasimi i borxheve	47.1	51.1	55.6	64.6	63.2	63.0	60.3	-	68.0	60.6	47.9	59.7
Korrupsioni	-	52.5	54.0	77.9	74.0	81.0	76.5	63.6	77.7	82.3	58.9	59.8
Furnizimi me energji elektrike	-	61.4	-	-	-	-	86.3	61.7	51.7	43.0	51.2	57.2
Transporti	-	76.3	65.5	66.7	69.6	74.5	77.7	35.9	39.3	44.7	35.7	51.2
Telekomunikimi	-	79.4	-	-	-	-	77.7	29.9	36.1	36.2	32.0	47.6
Siguria dhe stabiliteti politik	-	-	74.4	78.5	80.7	77.4	65.3	43.8	67.5	65.7	52.2	57.6
Administrata tatimore joefikase	-	-	-	-	-	-	-	46.5	60.3	53.3	53.8	62.8
Doganat	79.5	79.3	80.3	83.5	81	77.5	-	45.1	53.9	-	47.0	60.6
Procedurat e licensimit	-	-	-	-	-	-	-	36.1	43.7	49.1	43.8	-
Krimi dhe vjedhja	-	-	-	-	-	-	71.3	75.2	72.4	73.0	57.3	61.0
Haraçi	-	-	-	-	-	-	-	-	67.7	47.4	47.3	-
Konkurrenca jo fer	80.7	79.8	79.9	77.9	82.9	82.8	76.5	59.5	83.4	81.3	-	-
Aftësitë dhe arsimimi i punëtorëve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	38.7	55.1
Migrimi i punëtorëve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	75.2
Evazioni fiskal dhe informaliteti	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	57.0	63.5

Burimi: Instituti Riinvest

## 2.2 Rregullativa ligjore dhe fiskale

Në këtë grup të barrierave janë përfshirë çështjet që kanë të bëjnë me sistemin fiskal (normat tatimore, administrata tatimore), percepticioni që ka të bëjë me doganat si dhe ligjet dhe sistemin gjyqësor në përgjithësi. Vlen të theksohet që percepticionit i bizneseve lidhur me këto lloj barrierash është përmirësuar relativisht pak me kalimin e viteve. Shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe njohja ndërkombëtare e sovranitetit çuan në reforma dhe rritje të stabilitetit, duke adresuar pjesërisht një pjesë të shqetësimeve që lidhen me kornizën ligjore por edhe duke ndërmarrë reforma fiskale. Sipas të dhënave të bazuara në sentimentin e biznesit, pas vitit 2017 ka pasur përmirësime, ndonëse me disa luhajtje. Këto vite korrespondojnë me përpjekjet e Kosovës për të përmirësuar më tej sistemin e saj ligjor dhe gjyqësor. Qeveritë janë fokusuar në forcimin e shtetit ligjor dhe sigurimin e një mjedisi ligjor më të parashikueshëm, duke ndikuar pozitivisht në perceptimin e këtyre barrierave.

## 2.3 Investimet dhe barrierat financiare

Edhe pse qasja në kredi në Kosovë në mënyrë konsistente ka qenë e pranishme si pengesë, ndonëse me intensitet mesatar, viteve të fundit ka pasur një përmirësim. Nga viti 2000 deri në vitin 2007, qasja në kredi dukej se po përmirësohej gradualisht, duke reflektuar përpjekjet e sektorit bankar për të krijuar një mjedis financiar më të përshtatshëm. Ndërkaq, kostoja e financimit si pengesë e vlerësuar nga percepticioni i bizneseve, është përcjellur me disa luhajtje jo të ndjeshme. Pavarësisht faktit, që kreditimi për sektorin privat është rritur rritur ndjeshëm gjatë dekadës së fundit (kryesisht nga sektori bankar me pronësi të huaj), gjithashtu edhe rënia e normave të interesit dhe kredive jo-performuese, bizneset ende përballen me kufizime në qasjen e kredisë nga bankat. Kjo vlen veçanërisht për ndërmarrjet mikro të cilat nuk mund të përmbushin kërkesat rigorozë të bankave për kredi. Për shembull, mbi 90% e kredive në Kosovë kërkojnë kolateral, vlera e të cilit i tejkalon vlerat rajonale dhe globale (Banka Botërore, 2020). Përveç qasjes si dhe koston së financimit, në këtë kontekst është thelbësore të merren parasysh edhe dy faktorë të tjerë që ndikojnë dukshëm në mjedisin e biznesit në Kosovë, ngarkesat administrative dhe inkasimi i borxheve. Bazuar në të dhënat primare me bizneset

nga Instituti Riinvest (Tabela 7), këto dy lloj pengesash siç shihet edhe nga vlera e pikëve të intensitetit nuk kanë shfaqur ndryshime të ndjeshme ndër vite; luhajtjet e vogla të të intensitetit, edhe pse mesatar, të këtyre pengesave tregojnë se ato mbeten sfida të vazhdueshme me të cilat ballafaqohen bizneset në Kosovë. Vlen të theksohet që vitin e kaluar Qeveria e Kosovës ka miratuar Programin për Parandalimin e Barrës Administrative (2020-2027) – një iniciativë ndërinstucionale e cila synon të zvogëlojë barrën administrative për qytetarët, bizneset dhe shoqërinë (ZKM, 2022). Si pjesë e këtij programi, Kosova ka lansuar një vlerësim bazë të të gjitha ngarkesave administrative për bizneset, duke identifikuar 11 ligje, 26 akte nënligjore dhe 2 vendime të ministrisë që duhet të ndryshohen ose shfuqizohen për të përmirësuar mjedisin e biznesit për NVM-të (ZKM, 2022). Pengesat me të cilat ballafaqohen bizneset vendore mund gjithashtu të reflektohen edhe në mungesën e interesimit për investime të huaja në Kosovë.

## 2.4 Ekonomia informale dhe korrupsioni


Informaliteti, evazioni fiskal, dhe korrupsioni fatkeqësisht ende mbeten sfida jo pak të lehta për zhvillim të sektorit privat në Kosovë. Kronologjikisht, nga të dhënat e nxjerra nga Instituti Riinvest, barrierat lidhur me informalitetin dhe korrupsionin në Kosovë shprehin trende të ndryshme. Korrupsioni është një pengesë mjaft e madhe për bizneset meqë ndikon negativisht në kostot operative dhe po ashtu pamundëson konkurrencën e shëndetshme të tregut. Pavarësisht përpjekjeve institucionale për zbutjen e korrupsionit, fatkeqësisht nuk mund të themi që Kosova ka arritur ta adresojë efektivisht zvogëlimin e korrupsionit. Perceptimi i bizneseve lidhur me këtë mbetet me oscilime të vogla, por i lartë. Këshilli Gjyqësor vitin e kaluar ka miratuar një plan strategjik për zgjidhjen efikase të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, një strategji komunikimi për 2022-2024 si dhe Planin Strategjik për Qasje në Drejtësi për 2022-2025. Megjithatë, zbatimi i tyre nuk mund të themi që monitorohet në mënyrë efektive. Viteve të fundit, siç sugjerojnë edhe të dhënat nga studimet e ndryshme të Instituti Riinvest (dy raundet e fundit të anketave me bizneset në tabelën 1), vërehet një përparim i kufizuar; mirëpo, nevojiten përpjekje të vazhdueshme dhe qasje më proaktive e të gjithë akerëve relevant për një funksionim efektiv të gjithë sistemit të drejtësisë.



Sfidë për bizneset në Kosovë paraqet edhe informaliteti - i vlerësuar me rreth 30% të PVB-së (Komisioni Evropian, 2021). Aktualisht, për adresimin e këtij fenomeni qeveria e kalur kishte miratuar Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare (2019-2023). Kjo strategji ka si fokus rritjen e stimujve të pajtueshmërisë vullnetare për bizneset dhe përmirësimin e kapaciteteve inspektuese të administratës. Deri tani, është arritur të përmbushet pjesërisht ajo çfarë është synuar, ku nga 71 aktivitete, 62% prej tyre janë zbatuar (Qeveria e Kosovës, 2023). Një ambient i biznesit i cili karakterizohet me informalitet të lartë i pengon firmat

e reja, legale dhe inovative të rriten dhe të krijojnë vende të reja pune në treg. Ky fenomen dërgon sinjale shqetësuese edhe tek investorët e huaj, të cilët mund të hezitojnë për të investuar në Kosovë. Gjithashtu të dhënat nga studimet e ndryshme të Institutit Riinvest (2011-2023) kanë bërë vlerësimin e nivelit të mosdeklarimit të të hyrave për arsye tatimore nga bizneset. Siç edhe mund të shihet në figurën 6, nga viti 2011 vërehet një rënie e lehtë e nivelit të të hyrave të cilat nuk deklarohen nga bizneset për arsye tatimore; niveli i të hyrave të padeklaruara në vitin 2011 ishte 39 përqind ndërsa në vitin 2022 (të dhënat e grumbulluara në vitin 2023 për. Vitin fiskal 2022) kjo përqindje ishte më e ulët për 5 pikë përqindje.

● **Figura 6.** Biveli i evazionit fiskal në Kosovë



Burimi: Institut Riinvest

## 2.5 Tregu i punës dhe barrierat e ndërlidhura me ndërmarrësinë

Në Kosovë, përkundër optimizimit të bizneseve për rritje në periudhë afatmesme, vështirësia në gjetjen e punëtorëve të rinj me shkathhtësitë e nevojshme ka qenë sistematikisht ndër sfidat më serioze të bizneseve (Riinvest, 2021). Në Anketën e fundit të Mjedisit të Biznesit dhe Performancës së Ndërmarrjeve (BEEPS 2018-2020), rreth 45% e firmave identifikuan arsimimin joadekuat të punëtorëve si pengesë kryesore. Kjo lë të kuptohet që papunësia dhe niveli i lartë i vazhdueshëm i papunësisë ka karakter strukturor. Sistemi i VET-it në Kosovë është i organizuar sipas profileve të specializuara, megjithatë këto profile në të shumtën e rasteve nuk përputhen me nevojat e tregut të punës. Megjithatë, viteve të fundit janë bërë përpjekje të rëndësishme për të përmirësuar sistemin e arsimit nëpërmjet reformave të tilla si krijimi i kornizave të reja të kurrikulave që përfshijnë mësimin e bazuar në punë, apo edhe orientimi në karrierë në institucionet e arsimit të lartë. Sa i përket pengesave të ndërlidhura me potencialet e ndërmarrjes, të dhënat historike shpërfaqin trende të luhatshme. Përderisa aftësisë menaxhuese deri në vitin 2023 nuk janë parë si pengesë, nga të dhënat e anketës së fundit (2023) të Institutit Riinvest vërehet që perceptimi për këtë ka ndryshuar dhe ngjashëm me të edhe për shkathhtësitë dhe arsimimi adekuat i punëtorëve perceptohet nga bizneset si barrierë me intensitet mesatar (Tabela 10). Duke qenë se numri më i madh i bizneseve të regjistruara në Kosovë janë të mikro, të vogla dhe të mesme, shpeshherë pronarët e këtyre bizneseve nuk investojnë në zhvillimin e

personelit të tyre ose nuk punësojnë punëtorë me aftësi dhe përvojë të mjaftueshme për të zënë pozita udhëheqëse.

## 2.6 Barrierat administrative dhe infrastruktura

Marrja e licencave në Kosovë zgjat shumë më tepër se sa në ekonomitë e tjera të zhvilluara. Për shembull, marrja e një leje ndërtimi në Kosovë zgjat mesatarisht 273 ditë (krahasuar me mesataren e OECD prej 152 ditësh) dhe kërkon 18 procedura (mesatarja e OECD-së është 13) (OECD, 2021). Këto vështirësi potencialisht mund të pengojnë bizneset e reja të hyjnë në treg. Një sistem licencimi i qartë, transparent dhe efikas është thelbësor për nxitjen e sipërmarrjes dhe tërheqjen e investimeve. Pas vitit 2008 në Kosovë janë bërë investime të mëdha në infrastrukturën rrugore dhe telekomunikacion. Shembuj të investimeve në infrastrukturë përfshijnë ndërtimin e autostradave të reja, përmirësimin e rrugëve ekzistuese dhe modernizimin e infrastrukturës së energjisë elektrike. Këto përpjekje janë përqendruar në përmirësimin e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët dhe në zhvillimin e një mjedisi të favorshëm për bizneset (EBRD, 2013). Megjithatë, kriza e fundit energjetike në Evropë ka ndikuar që edhe Kosova të ballafaqohet me pasiguri rreth furnizimit gjatë sezonës së dimrit. Kjo pasiguri është reflektuar edhe tek bizneset meqë nga të dhënat e anketës së fundit me biznese të Institutit Riinvest (2023), furnizimi me energji elektrike shihet si një pengesë me intensitet relativisht të lartë për zhvillim të biznesit (tabela 10).

### Sektori energjetik dhe mjedisi biznesor

Edhe pse prodhimi vendor i energjisë përmbush një pjesë të madhe të kërkesës, importet e energjisë janë të domosdoshme gjatë periudhave të ngarkesës së konsumit. Kapacitetet e energjisë së rinovueshme kanë pasur një rritje modeste, duke përfshirë hidroenergjinë, energjinë e erës dhe atë diellore, por dominimi i gjenerimit të energjisë nga linjiti i zbeh këto avancime. Këto zhvillime ndikojnë në stabilitetin dhe kostot e biznesit. Mungesa e fleksibilitetit të sistemit energjetik, shkaktuar nga koncentrimi i gjenerimit në termocentralet shumë të vjetra përcillet edhe me defekte në furnizim. Këto dinamika u shkaktajnë ndërprerje të shpeshta bizneseve, duke prekur stabilitetin e punës që bëjnë dhe planifikimin financiar të tyre; gjithashtu dekurajon investitorët potencialë, dhe duke e bërë më të vështirë zhvillimin e bizneseve ekzistuese. Ajo që është e domosdoshme të bëhet menjëherë është të diversifikohet miksi i burimeve të furnizimit me energji duke përfshirë edhe eksplorimin e mundësisë së furnizimit me gaz. Është e nevojshme ndërtohet një infrastrukturë më e qëndrueshme. Edhe pse ka pasur përmirësime të indikatorëve të besueshmërisë së furnizimit me energji në vitin 2022, problematikat themelore të sektorit të energjisë vazhdojnë të ekzistojnë, duke krijuar një mjedis biznesi sfidues dhe të pasigurt sa i përket furnizimit stabil me energji elektrike.

Në fund duhet theksuar se ndër barrierat institucionale të cilat kanë karakter politik më problematike kohëve të fundit janë tensionet e vazhdueshme në veri të vendit. Lidhur me tensionet atje dhe procesin negociator Bashkimi Evropian vendosi të ndër marrë masa të përkohshme, duke pezulluar takimet e nivelit të lartë dhe vizitat dypalëshe, si dhe duke tërhequr financimin nga fondet e IPA. Këto janë faktorë që

ulin besimin e bizneseve vendore dhe poashtu investitorëve të huaj. Sa i përket pengesave që lidhen me infrastrukturën, vërehet dukshëm një përmirësim në perceptcionin e bizneseve pas vitit 2011; transporti dhe shërbimet e telekomunikimit në përgjithësi nuk shihen si pengesa në të bërit biznes në Kosovë.



**TREGU I PUNËS**

**3**

### 3.1 Hyrje

Kosova aktualisht po përballet me disa sfida të tregut të punës, duke përfshirë, ndër të tjera, papunësinë e lartë (veçanërisht për të rinjtë dhe gratë), shkallën e ulët të pjesëmarrjes, mungesën e punëtorëve të kualifikuar dhe zvogëlimin e fuqisë punëtore për shkak të emigrimit të konsiderueshëm. Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të sfidave të tregut të punës në Kosovë me të cilat përballet sektori privat.

Mospërputhja e aftësive përfaqëson një pengesë të rëndësishme, e lidhur ngushtë me paaftësinë e shkollave të arsimit dhe formimit profesional (AFP) dhe institucioneve të arsimit të lartë (IAL) për t'i ofruar sektorit privat fuqinë punëtore të kualifikuar që kërkon. Kjo ka një ndikim të dëmshëm në konkurrencën e ekonomisë. Brenda sistemit arsimor, ekziston një sfidë e vazhdueshme që lidhet me kapacitetin e pamjaftueshëm institucional për të lidhur punëkërkuësit me mundësitë e punësimit, për të lehtësuar trajnimin efektiv dhe për të krijuar mekanizma për të siguruar ofrimin e arsimit dhe trajnimit me cilësi të lartë (Komisioni Evropian, 2022). Mbi gjysma e bizneseve raportojnë se punonjësve të tyre u mungojnë aftësitë adekuate dhe relevante, siç pranohej edhe nga politikëbërësit (Qeveria e Kosovës, 2022). Sfidë mbetet plotësimi i vendeve të lira të punës, veçanërisht për pozitat me aftësi të larta dhe të mesme (Krasniqi dhe Hashi, 2021). Riinvest (2019) zbulon se një e treta e bizneseve përballen me vështirësi punësimi në profesione të zgjedhura, të cilat konfirmohen edhe në këtë studim, siç shpjegohet në seksionin vijues.

Ngjashëm me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (BP6) (Icoski, 2022; Leitner, 2021; Mara dhe Vidovic, 2020; Banka Botërore dhe wiiw, 2019), intensiteti i migrimit të punonjësve të kualifikuar dhe të arsimuar, përfshirë të rinjtë, mbetet një sfidë në Kosovë. Vendet e rajonit BP6 renditen ndër vendet më të prekura nga ikja e trurit në shkallë globale (Icoski, 2022). Përqindja më e lartë e emigranteve të mbikualifikuar është nga BP6 krahasuar me popullsinë e huaj lindur në vendet e OECD (OECD, 2022). Sipas projeksionit të Mara dhe Landesman (2022), nga viti 2020 deri në 2030, do të ketë një trepricë dhe mungesë të fuqisë punëtore bazuar në grupe të ndryshme aftësish në BP6. Sipas këtij studimi, Kosova pritet të ketë mungesë të fuqisë punëtore të atyre me arsim të ulët dhe të lartë, dhe trepricë të punëtorëve me arsim të mesëm.

Migrimi i fuqisë punëtore pritet të bëhet një çështje gjithnjë e më urgjente, veçanërisht për Kosovën që pritet të udhëtojë pa viza në Zonën Shengen në vitin 2024. Liberalizimi i vizave u gjet të jetë një faktor i rëndësishëm kontribues në rritjen e emigracionit, duke përfshirë pjesa e të rinjve (Lavrič, 2020).

Analizimi i prirjes për të migruar dhe reagimi i vendosur në lidhje me migracionin ka implikime të rëndësishme politike dhe menaxheriale. Duke bërë këtë, ne kemi hetuar edhe dy modele: (i) përcaktuesit që nxisin emigrimin nga Kosova, me theks të veçantë në demografinë e të rinjve (KUTIA 3); dhe (ii) karakteristikat e bizneseve që kanë humbur punëtorët për shkak të migrimit (KUTIA 4). Rezultatet e këtyre modeleve dhe ato nga analiza përshkruese ofrojnë rekomandime rëndësishme të politikave.

### 3.2 Vështrim i përgjithshëm i tregut të punës në Kosovë

Treguesit e tregut të punës përbëjnë një sfidë të vazhdueshme për politikëbërësit dhe zyrtarët e qeverisë. Ndërkohë që ka pasur disa përmirësime në këta tregues, ka ende hapësirë të mjaftueshme për zbatimin e politikave dhe mekanizmave më të sofistikuar për t'i përmirësuar ato më tutje. Ndër shqetësimet kryesore sa i përket tregut të punës janë norma e lartë e papunësisë, veçanërisht të rinjve dhe grave, dhe nivelet e larta të pasivitetit. Këta faktor kur kombinohen me mospërputhjen e aftësive dhe shkalla e konsiderueshme e migrimit, nënvizojnë nevojën urgjente për ndërhyrje më të menjëhershme dhe gjithëpërfshirëse të politikave për të adresuar këto çështje dhe për të promovuar mirëqenien socio-ekonomike.

● **Tabela 11.** Treguesit kryesorë të tregut të punës (% e popullsisë në moshë pune)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Pjesëmarrja në fuqinë punëtore	37.6	38.7	42.8	40.9	40.5	38.3	39.3	38.6
Shkalla e jo aktivitetit	62.4	61.3	57.2	59.1	59.5	61.7	60.7	61.4
Të punësuar/popullsia totale	25.2	28.0	29.8	28.8	30.1	28.4	31.1	33.8
Shkalla e papunësisë	32.9	27.5	30.5	29.6	25.7	25.9	20.7	12.6
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24)	57.7	52.4	52.7	55.4	49.4	49.1	38.0	21.4
Punësim i paqëndrueshëm (15-64)	22.8	22.9	23.1	19.6	18.8	17.0	12.7	13.3
Papunësia afatgjatë <sup>14</sup>	74.5	65.5	65.5	58.4	63.6	71.7	70.8	65.1

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: Treguesit e tregut të punës

Sfida e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore vazhdon të jetë problematike, me një normë mesatare prej 39.6 përqind të regjistruar gjatë periudhës 2015-2022. Inkurajuese mund të vlerësohet ulja e papunësisë tek të rinjtë nga 57.7 përqind në vitin 2015 në 21.4 përqind në vitin 2022. Në mënyrë të ngjashme, ka pasur një rënie indikatorin e punësimit të paqëndrueshëm gjatë dy viteve të fundit krahasuar me vitin 2015. Ndërsa shkalla e papunësisë është ulur (në 12.6 përqind në 2022), shkalla e punësimit si përqindje e popullsisë mbetet e ulët (33.8 përqind). Duket se rënia e shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ka pasur ndikim në shifrat më të ulëta të papunësisë, e ndikuar pjesërisht edhe nga migrimi. Këto statistika janë veçanërisht shqetësuese për të rinjtë dhe gratë, ku ende përqindja duke u bazuar në demografinë e fuqisë punëtore mbetet e lartë.

Në mënyrë të ngjashme, papunësia afatgjatë ka parë një ulje modeste, megjithëse ajo mbetet dukshëm e lartë. Numri i punëkërkuessve gjatë tre tremujorëve të vitit 2023 është

rritur krahasuar me vitin 2022, ku përqindja më e lartë e punëkërkuessve është tek femrat krahasuar me meshkujt. Për të dyja gjinitë, pjesa më e madhe e punëkërkuessve bie në grupmoshën 25-39 vjeç. Vlen të theksohet se papunësia afatgjatë nuk mund të rezultojë vetëm nga mungesa e mundësive të punës në dispozicion, por gjithashtu mund të lidhet me praninë e konsiderueshme të punësimit joformal në Kosovë, pjesërisht e shkaktuar nga shtrembërimet që paraqesin skemat e mbrojtjes sociale.

### 3.3 Kërkesa për fuqi punëtore dhe vështirësi në plotësimin e pozicioneve

Hulumtimet e mëparshme kanë treguar se sektorët eksportues me potencial për gjenerimin e punësimit janë sektorë të prodhimit si prodhimi i veshjeve, tekstileve, ushqimit dhe ndërtimit. Përpunimi i drurit është një tjetër sektor

14 Shënim: Papunësia më e gjatë se 1 vit ose Kohëzgjatja e papunësisë për më shumë se një vit të totalit të të papunëve i referohet personave që kanë qenë të papunë për më shumë se 12 muaj.

i rëndësishëm me potencial të lartë rritjeje, punësim dhe eksport. Në shërbime, industria e TIK-ut është tashmë një burim i rëndësishëm punësimi dhe potencialisht mund të transformojë ekonominë e Kosovës, duke pasur parasysh ndikimin e drejtpërdrejtë në sektorët e tjerë dhe formimin e kapitalit njerëzor (Riinvest, 2019).

Studimi i Riinvest tregon se 33.8 përqind e bizneseve kanë punësuar punonjës të rinj gjatë tre viteve të fundit. Gjithashtu, në tre vitet e ardhshme, bizneset presin të rrisin numrin e të punësuarve në profesione si: zeytari dhe punëtorë të tjerë të tregtisë. Kërkesa për profesione të tjera, profesionistë, punëtorë elementare dhe menaxherë është nën mesataren dhe vendet e reja të punës që pritet të krijohen përfshijnë punëtorët e shitjes, kamerierët dhe banakierët, punëtorët e ndërtimit dhe tregtisë së ngjashme, dhe punëtorët në miniera, ndërtim, prodhim, dhe transportit. Këto përbëjnë pothuajse gjysmën e vendeve të reja të punës. Megjithatë, përveç sfidës së rritjes nga ana e kërkesës, është mungesa e ofertës me rritjen e prirjes për të migruar (diskutuar më tej në këtë kapitull) paraqesin sfidë për sektorin privat. Prandaj, bazuar në trendet aktuale, bizneset do të përballen me sfida në mbajtjen e punonjësve të tyre.

